

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

Numri rendor (1)	Data e regjistrimit të kërkesave (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Statusi i kërkesës (5)	Tarifa në leke (6)
01	01.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>02.02.2016</b> Nisur nga emailt tuaja, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Aplikimi Juaj, figuron te jete pezulluar me arsyen: “Te saktosohet vlere e kapitalit ne aktin e themelimit, pasi ne nenin 1, te aktit te themelimit eshte percaktuar 30 000 euro dhe nenin 5, eshte percaktuar 4 000 000. Gjithashtu te percaktohet vlere e kapitalit perssecilin ortak.”</p> <p>Nga sa me siper, duhet te kryeni plotesimin e te metave qe pengojne regjistrimin brenda afatit ligjor te percaktuar ne nenin 56 te ligjit 9723/2007 “Per QKR”.</p> <p>Lidhur me Kodin Ekonomik, per me teper informacion mund tu drejtoheni organeve tatimore, si dhe mund te merrni informacion ne faqen zyrtare te Institutit te Statistikave: <a href="http://instat.gov.al">instat.gov.al</a>.</p>	Perfunduar	Nuk ka
02	21.01.2016	Kerkese per informacion	<p><b>08.02.2016</b> Nisur nga emaili juaj, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Subjekti Juaj (person fizik), me aplikimin me numer CN-211123-01-09, date 27.01.2009, ka aplikuar per pezullim te aktivitetit me afat (deri me 30.06.2009). Per kete arsye ky subjekt me CN-279539-08-09 eshte aktivizuar nga sistemi.</p> <p>Se fundi, me aplikimin me numer CN-498586-01-16, subjekti si me siper ka aplikuar per pezullim te aktivitetit pa afat, nderkohe qe per shkak te nje gabimi teknik eshte aktivizuar nga sistemi. Aktualisht situatë eshte sistemuar dhe subjekti figuron me status: Pezulluar.</p>	Perfunduar	Nuk ka
03	05.01.2016	Kerkese per informacion	<p><b>02.02.2016</b> Nisur nga emaili juaj ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Aplikimi per regjistrim fillestar eshte pezulluar me arsyen: “Te saktosohet datelindja e administratorit ne nenin 16 te</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>statutit te depozituar.”</p> <p>Nga verifikimi i kryer, referuar dokumentit te identifikimit te administratorit, datelindja rezulton te jete: 19.03.1988 dhe jo 09.03.1988.</p> <p>Nga sa me siper, duhet te plotesohen te metat qe pengojne regjistrimin, referuar nenit 56 te ligjit 9723/2007 “Per QKR”, i ndryshuar.</p>		
04	28.01.2016	Ankesë	<p>02.02.2016</p> <p>Nisur nga emaili juaj ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Aplikimi per çregjistrim me numer CN-550152-05-11, i kryer per subjektin (person fizik) eshte refuzuar me arsyen: "Ne baze te Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe Ligjit Nr.9920, datë 14.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 45/4, QKR nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit. Sipas shkresës nr.27038/1, date 23.06.2011, ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoha apo interesa të papaguara me vlerë 10 000 leke dhe sipas shkresës nr.1081/1, date 27.06.2011, ardhur nga Bashkia Tiranë, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoha apo interesa të papaguara me vlerë 16 033 lekë."</p> <p>Me shkresën Nr.Prot. K109/1, date 26.01.2015, ardhur nga Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkise Tiranë, eshte konfirmuar likujdimi i detyrimeve tatimore deri ne vitin 2011 në zbatim të procedurave per çregjistrim, per subjektin tuaj. Nderkohe qe DRT Tiranë nuk e ka terhequr kundërshtimin per çregjistrim, referuar nenit 45 te ligjit 9920 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise” dhe për këtë arsye ky subjekt nuk është çregjistruar.</p>	Perfunduar	Nuk ka
04	02.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>02.02.2016</b></p> <p>Ju bejme me dije se, shqyrtimi i aplikimeve kryhet ne perputhje me nenin 54, 55, 56, 57 te ligjit 9723/2007 “Per QKR”, i ndryshuar.</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>Referuar nenit 55 të ligjit të sipercituar, nese QKR-ja, pasi kryen verifikimet përkatëse, sipas nenit 54 të këtij ligji dhe vëren përmbushjen e kushteve për regjistrim, kryen regjistrimin në regjistër brenda një afati prej një dite nga data e paraqitjes së aplikimit.</p> <p>Referuar nenit 56, në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 54, të këtij ligji, rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim, nuk janë paguar tarifat përkatëse të regjistrimit, ka sanksione administrative të papaguara apo nuk janë kryer regjistrimet e kërkuara, sipas nenit 46, QKR-ja pezullon aplikimin dhe e njofton aplikuesin me shkrim për shkakun e saktë të pezullimit, duke i dhënë një afat prej 21ditësh kalendarike për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari standard të QKR-së. Nëse aplikanti plotëson ose ndreq elementet që pengojnë regjistrimin, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, QKR-ja është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda një afati 1-ditor nga data e plotësimit ose ndreqjes së dokumentacionit. Në këtë rast, regjistrimi mban datën e paraqitjes së aplikimit të parë.</p> <p>Nga verifikimi i kryer rezulton se, aplikimi për aktivizim të aktivitetit të pezulluar, për subjektin e përmendur në emailin tuaj është kryer sot me datë 02.02.2016 ora 8:55.</p> <p>Sa me sipër, shqyrtimi i aplikimit tuaj do të kryhet në përputhje me sa parashikohet në nenet e sipercituara.</p> <p>Lidhur me gjendjen e aplikimit tuaj, mund të informoheni në faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek menu: Sherbime të reja, nenmenu: Kontrolllo statusin e aplikimit për regjistrim, si dhe duke gjeneruar ekstraktin historik.</p>		
06	02.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>03.02.2016</b></p> <p>Nga verifikimi i kryer rezulton se, aplikimi me numer CN-524214-01-16, figuron të jete miratuar.</p> <p>Verifikimin mund ta kryeni në faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek menu: Sherbime të reja, nenmenu: Kontrolllo statusin e</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			aplikimit per regjistrim, si dhe duke gjeneruar ekstraktin historik.		
08	28.01.2016	Kerkese per informacion	<p><b>04.02.2016</b> Nisur nga emaili juaj, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Aplikimi me numer CN-521259-01-16, figuron te jete pezulluar me arsyen:</p> <p>"Ne baze dhe per zbatim te udhezimit Nr. 16, pika 2.3.10, date 25.07.2012, per disa shtesa e ndryshime ne Udhezimin nr.5 date 30.06.2006 "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, duhet te paraqitet deklarimi i individeve kontribues nga Drejtoria Rajonale e Tatimore i cili konfirmon te dhenat, per sa i perket zmadhimit te kapitalit ne forme monetare nga jashte shoqerise."</p> <p>Pika 2.3.10 e Udhezimit nr.5 date 30.06.2006 "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, citon:</p> <p>"Në germën "h", të nenit 8 "Të ardhura të tatueshme" të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, në të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, përfshihen të ardhurat e individëve, në formë monetare që shkojnë për shtimin e kapitalit të shoqërisë, të përfituara nga jashtë shoqërisë. Nëse këto të ardhura të individëve nuk janë tatuar më parë, ndërkohë që kanë qenë e janë objekt i tatimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale, për këto të ardhura paguhet tatimi në masën 15%. Lidhur me origjinën e krijimit të të ardhurave në formë monetare, që shkojnë për rritjen e kapitalit të shoqërisë nga individi investues, duhet të paraqitet në organin tatimor një deklaram lidhur me origjinën e të ardhurave personale. Ky deklaram duhet të paraqitet sipas formularit 1 "Deklarimi i individit kontribues në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij, jo më vonë se data e derdhjes së të ardhurave për shtimin e kapitalit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR). Për individët e huaj ky deklaram duhet të paraqitet sipas formularit 2 "Deklarimi i individit kontribues të huaj në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë",</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij. Bazuar në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë kanë të drejtë të emërojnë me prokurë, një person, i cili e përfaqëson atë në raport me administratën tatimore, në rastet e pamundësisë për t'u paraqitur për kryerjen e veprimeve të mësipërme.</p> <p>Në këtë deklaram duhet përshkruar burimi i këtyre të ardhurave. Bashkëngjitur me këtë deklaram, duhet të vendoset dokumentacioni plotësues zyrtar që vërteton shumën e këtyre të ardhurave dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale, përpara se këto të ardhura të investohen për shtimin e kapitalit të shoqërisë. Nëse ky dokumentacion mungon ose nuk vërteton, që për vlerën e plotë të të ardhurave të kontribuara është paguar tatimi mbi të ardhurat personale, mbi këtë vlerë të të ardhurave duhet të paguhet tatimi mbi të ardhurat në masën 15% Ky tatim do të paguhet në të njëjtën datë që individi do të deklarojë të ardhurën monetare për shtimin e kapitalit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Pagesa e tatimit mbi të ardhurën për kontributin në kapitalin e shoqërisë duhet të derdhet nga individi kontribues, në llogarinë bankare të Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku shoqëria është e regjistruar, me përshkrimin në dokumentin bankar të pagesës: Derdhur tatim mbi të ardhurat për shtimin e kapitalit të shoqërisë :</p> <p>Drejtoria rajonale tatimore, me marrjen e dokumentacionit të mësipërm dhe një kopje të mandatpagesës së tatimit, pajis individin me vërtetim sipas formularit 3 “Vërtetim i drejtorisë rajonale tatimore mbi të dhënat e deklaruara nga individi kontribues në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij, ku konfirmohen të dhënat e deklaramit.</p> <p>Këtë vërtetim së bashku me kopjet e dokumentacionit të paraqitur në drejtorinë rajonale tatimore, individi ia dorëzon shoqërisë e cila ia bashkëlidh kërkesës për aplikim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për zmadhim e kapitalit. Mungesa e tij e bën aplikimin të pavlefshëm dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit nuk procedon për regjistrimin e</p>	
--	--	--	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Procedura e mësipërme për rritjen e kapitalit zbatohet për të ardhurat me burim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Nga sa me sipër, duhet të plotesohen të metat që pengojnë regjistrimit, duke paraqitur dokumentacionin që percaktohet si me sipër në përputhje me ligjin.</p>		
11	04.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>08.02.2016</b> Nisur nga emaili juaj, ju sqarojmë si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Se pari, ne faqen zyrtre te QKR-se, tek rubrika njoftime ka qene i publikuar njoftimi ne lidhje me dorëzimin e bilancit, njoftim te cilin mund ta gjeni edhe sot. Referuar ketij njoftimi, ky shërbim ofrohet vetëm nëpërmjet aplikimit online në portalin qeveritar e-albania (<a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a>) (neni 70 i Ligjit Nr. 9723/2007).</li> </ul> <p>Ju bejme me dije se, nje numer i madh subjektesh, ne korrik 2015 aplikuan online per depozitimin e bilaceve, në portalin qeveritar e-albania (<a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Se dyti, ju bejme me dije se, perditeseimi i te dhenave te subjekteve ne QKR, ka nisur qe ne shkurt te vitit 2015. Gjithashtu, theksojme se, aplikimet online për depozitimin e pasqyrave financiare, shmangen rradhet e subjekteve ne sportelet e QKR-se.</li> <li>- Se treti, sanksioni për mosdepozitimin e bilancit eshte parashiikuar ne piken 3 te nenit 74 te ligjit 9723/ 2007 “Per QKR”, i ndryshuar, ku citohet: “Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.”</li> </ul> <p>Ndersa neni 46 i ligjit 9723, date 03.05.2007 “Per QKR”, i ndryshuar”, citon: “1.Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë,në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>çdo rast t'i depozitohen këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.</p> <p>2. Nëse një subjekt nuk përmbush detyrimin, sipas këtij neni, atëherë QKR-ja, së bashku me zbatimin e sanksionit të parashikuar në pikën 3, të nenit 74, të këtij ligji, vepron në përputhje me parashikimet e shkronjës “ë”, të nenit 54, të këtij ligji.”</p> <p>- Se fundi, nga sa me sipër, depozitimi i bilancit behet nepermjet aplikimit online në portalin qeveritar e-albania (<a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a>)</p> <p>Lidhur me aplikimin online mund te informoheni ne faqen zyrtare te QKR-se, tek Seksioni: Regjistrimi online. Per marrjen e asistences se nevojshme per kryerjen e aplikimit online mund te drejtoheni edhe ne sportelet e QKR-se, si dhe mund te telefoni ne numrin: 04 225 00 66.</p>		
	04.02.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Cfare me keshilloni Te bej kur une jam kanadeze por lindur ne shqiperi me dokumenta si shoqerie e huaj, canadeze. Me respekte</p>	<p><b>09.02.2016</b> Pershendetje,</p> <p>Lidhur me pyetjen tuaj, sjellim në vëmendje Nenin 26 të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, (i ndryshuar), i cili parashikon se: “Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit apo nga çdo person i autorizuar prej tyre.”.</p> <p>Për sa më sipër, aplikimi mund të bëhet dhe nga çdo person i autorizuar (me prokurë) nga themeluesi (ortaku/aksionari), pranë çdo sporteli shërbimit të QKR, pavarësisht nga selia apo vendi i ushtrimit të veprimtarisë së subjektit që kërkon regjistrimin.</p> <p>Faleminderit!</p>	Perfunduar	Nuk ka
18	05.02.2016	Kerkese per heqje sekuestro	<p><b>12.02.2016</b> Ne pergjigje te emailit tuaj ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Me aplikimin me numer CN-549069-02-16 date 11/02/2016 figuron te jete kryer depozitim i urdhrat Nr.12/7 Dosje, datë 05.02.2016, lëshuar nga Përmbartues Gjyqësor Privat “Euglent</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			Osmanaj”, drejtuar QKR, ku është urdhëruar: Heqjen e masës se sekuestros konservative, të vendosur me anë të shkresës Nr.12/3, datë 11.03.2015, mbi aktivet e personit juridik. Ju bejme me dije se, pas procesimit të këtij aplikimi në përputhje me ligjin Nr.9723/2007 “Per QKR”, neni 54, pika 5, QKR, do të beje regjistrimin dhe publikimin e urdhrit Nr.12/7 Dosje, datë 05.02.2016 edhe për subjektin tuaj.		
19	06.02.2016	Ankese	<p><b>12.02.2016</b> Nisur nga email-i juaj, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Nga verifikimi i kryer rezulton se, aplikimi për çregjistrim me numer CN-818097-01-15, figuron të jetë refuzuar me arsyen si më poshtë: “QKR nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit, në bazë e për zbatim të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 45. Sipas shkresës nr.627/1... datë 27.02.2015, ardhur nga Bashkia Elbasan, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoha apo interesa të papaguara me vlerë 878 lekë .”</p> <p>Së dyti, ju bëjmë me dije se, edhe aplikimi i mëvonshëm për çregjistrim me numer CN-963476-03-15, i kryer për subjektin e sipërcituar figuron të jetë refuzuar me arsyen: “QKR nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit, në bazë e për zbatim të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 45. Çështja refuzohet, pasi sipas shkresës nr.2681/1, date 17.04.2015, ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoha apo interesa të papaguara me vlerë 2015 lekë dhe sipas shkresës nr.627/1..., date 27.02.2015, ardhur nga Bashkia Elbasan, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoha apo interesa të papaguara me vlerë 878 lekë.”</p> <p>Me shkresën Nr.5092/1 Prot., date 08.07.2015 të Drt Elbasan,</p>	Perfunduar	Nuk ka



## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>protokolluar nga QKR me Nr.9516 Prot., date 10.07.2015, eshte rikonfirmuar se subjekti juaj, i cili ka aplikuar per mbyllje nuk ka detyrime.</p> <p>Nga sa më sipër QKR, nuk mund të kryejë çregjistrimin, pasi organi tatimor kompetent, konkretisht Bashkia Elbasan, nuk e ka terhequr kundërshtimin për çregjistrimin e tij</p>		
13	08.02.2016	Kerkese per rezervim emertimi tregtar	<p><b>09.02.2016</b></p> <p>Ne pergjigje te emailit tuaj, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Pika 1 e VKM 537 date 01.08.2007 “Per rregullat per emrat dhe emertimet tregtare”, citon:</p> <p>“ a) “Emri i personit juridik” është emri me të cilin personi juridik (përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja) është regjistruar në regjistrin tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (në vijim QKR).</p> <p>b) “Emërtimi i personit juridik” është emërtimi tregtar i personit juridik (përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja), që përdoret në kursin e tregut, e që mund të jetë i ndryshëm nga emri me të cilin është regjistruar në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, që mund të jetë pjesë ose akronim i emrit të regjistruar, i njoftuar vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.”</p> <p>Neni 24 i ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR”, i ndryshuar, percakton se, çdo individ, duke paguar tarifën përkatëse, ka të drejtë të rezervojë pranë regjistrit tregtar, për llogari të tij apo të të tretëve, një apo më shumë emra të caktuar për regjistrimin.</p> <p>Ky nen parashikon qe, çdo individ ka te drejte te aplikojte per “Rezervim emri” dhe jo per rezervim te emertimit tregtar.</p> <p>Mund te aplikohet prane çdo sporteli sherbimi te QKR-se, per publikimin e emertimit tregtar apo shenjave dalluese të veprimtarisë, të njoftuar vullnetarisht, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në.</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

	09.02.2016	<p>Pershendetje, Do t'ju lutesha te me ndihmonit me nje informacion ne lidhje me dokumentacionin qe nevojitet per rritje te kapitalit.</p> <p>Behet fjale per nje kompani te huaj e cila ka celur degen e saj ne Shqiperi. Gjate 4-5 viteve te fundit kompania meme ka derguar transfertat bankare per mbulimin e shpenzimeve te kompanise ne Shqiperi, shume e cila eshte regjistruar ne pasqyrat financiare si hua. Kompania meme ka vendosur qe t'ia fale nje pjese te kesaj huaje kompanise ne Shqiperi me kushtin qe ta regjistroje si rritje te kapitalit. Cfare dokumentacioni duhet te paraqitet ne QKR per realizimin e kesaj procedure? Nese ju nevojitet ndonje sqarim i metejshe, ju lutem me kontaktoni me email ose telefon ne nr. 0692071053 Ju falenderoj paraprakisht!</p>	<p><b>16.02.2016</b> Pershendetje,</p> <p>Bazuar ne nenin 37 te ligjit 9723, date 03.05.2007 “ Per QKR”, deget dhe zyrat e perfaqesimit deklarojne:</p> <p>a) të dhënat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë” të nenit 32 të këtij ligji për shoqëritë e huaja, përfshirë numrin dhe vendin e regjistrimit;</p> <p>b) kapitalin e shoqërisë së huaj;</p> <p>c) emrin e degës ose të zyrës së përfaqësimit, nëse është i ndryshëm nga ai i shoqërisë së huaj;</p> <p>ç) kohëzgjatjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;</p> <p>d) fushën e veprimtarisë së degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;</p> <p>dh) selinë e degës ose të zyrës së përfaqësimit;</p> <p>e) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës ose zyrës së përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;</p> <p>ë) specimetet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën ose zyrën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët.</p> <p>Persa me siper deget dhe zyrat e perfaqesimit nuk deklarojne kapitalin themeltar.</p> <p>Per me shume informacion vizitoni faqen tone zyrtare <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a> .</p> <p>Faleminderit,</p>	Perfunduar	Nuk ka
16	10.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>11.02.2016</b> Nisur nga emaili juaj, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Se pari, Neni 46 i ligjit 9723/2007 “Per QKR”, i ndryshuar, citon: “Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t'i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.</p> <p>2. Nëse një subjekt nuk përmbush detyrimin, sipas këtij neni, atëherë QKR-ja, së bashku me zbatimin e sanksionit të parashikuar në pikën 3, të nenit 74, të këtij ligji, vepron në përputhje me parashikimet e shkronjës “ë”, të nenit 54, të këtij ligji.”</p> <p>Se dyti, lidhur me menyren e depozitimit të bilancit, mund të informoheni në faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek menu: Njoftime; Nenmenu: Njoftim në lidhje me dorezimin e bilancit, ku përcaktohet se: Ky shërbim ofrohet vetëm nëpërmjet aplikimit online në portalin qeveritar e-albania (<a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a>) (neni 70 i Ligjit Nr. 9723/2007).Shërbimi ofrohet pa pagesë.</p> <p>Informacion për aplikimin online mund të merrni në faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek Seksioni: Regjistrimi online.</p>		
17	10.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>11.02.2016</b> Nga verifikimi i kryer rezulton se, aplikimi për regjistrim me numer CN-768183-12-14, figuron të jetë refuzuar me arsyet:</p> <p>“QKR nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për regjistrimin e subjektit, në bazë e për zbatim të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 45. Sipas shkresës nr.453/1, datë 20.01.2015, ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoha apo interesa të papaguara me vlerë 337.623 lekë.”</p> <p>Verifikimin lidhur me gjendjen e aplikimit të kryer mund ta kryeni në faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek menu: Shërbime të reja, nenmenu: Kontrolllo statusin e aplikimit për regjistrim</p>	Perfunduar	Nuk ka
	11.02.2016	Pershendetje! Ju lutem doja nje informacion ,une si perfaqesuese dhe administratore kam vendosur edhe 2 administrator te tjere,por	<p><b>16.02.2016</b> Pershendetje,</p> <p>Referuar kerkeses tuaj, sqarojme:</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>tani ata duan te largohen dhe do te jem vetem une administratore .ju lutem mund te me thoni proceduren qe duhet te ndjek dhe dokumentat per largimin e tyre .Ju falenderoj per korrektesine dhe sherbimin .</p>	<p>Per shkarkimin e administrator ne nje shoqeri shpk duhen dokumentet si me poshte:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendimi i ortakut ose i asamblesë së ortakëve për ndryshimin e administratorit.</li> <li>2. Nqs aplikimi nuk kryhet nga administratori por nga nje përfaqesues aplikanti duhet të paraqesë autorizimin nga administratori.</li> <li>3. Dok. identifikimi i aplikantit ose personit te autorizuar, shtetas shqiptar (vetem me Leternjoftim Elektronik-Karte Identiteti)</li> </ol> <p>Per me shume informacion, vizitoni faqen tone zyrtare <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a> Faleminderit,</p>		
12.02.2016	<p>Po planifikoj te hap nje biznes me aktivitet kryesor "Keshillim Financiar@Fiskal", ne drejtimet e meposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konsulence ekonomike</li> <li>- Konsulence financiare</li> <li>- Konsulence fiskale</li> <li>- Deklarime tatimore</li> <li>- Plan-biznese</li> <li>- Konsulence kredimarrje</li> <li>- Menaxhim biznesesh(jopunesim).</li> </ul> <p>Nese mund t'me ndihmoni me nje pergjigje profesionale&amp;ligjore, pyetja ime eshte: nevojitet license profesionale(leshuara nga Qkl apo ndonje Ent tjeter) per te regjistruar&amp;ushtruar aktivitetin e mesiperme? Ju faleminderit.</p>	<p><b>26.02.2016</b></p> <p>Përsëhendetje,</p> <p>Lidhur me pyetjen tuaj, sqarojmë se:</p> <p>Për regjistrimin fillestar pranë regjistrit tregtar duhet të paraqitet dokumentacionin shoqërues përkatës si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dokument origjinal identifikimi i aplikantit;</li> <li>2. Dokumente të tjera shoqëruese. Lista e dokumenteve të kërkuara për regjistrimin fillestar është specifike për forma të ndryshme ligjore biznesesh. Pasi është identifikuar lloji i biznesit që do të regjistrohet, aplikanti mund të gjejë listën e dokumenteve shoqëruese, të bashkëngjitur në formën specifike të aplikimit për regjistrim, e cila mund të merret ose në sportelet e QKR-së ose në faqen zyrtare të internetit të QKR-së, në linkun : <a href="http://www.qkr.gov.al/nrc/Udhezime_Bij.aspx">http://www.qkr.gov.al/nrc/Udhezime_Bij.aspx</a> .</li> </ol> <p>Faleminderit!</p>	Perfunduar	Nuk ka	
13.02.2016	<p>PERSHENDETJE PER te hapur nje ( kafe bar ) cfar dekumenda duen si dhe sa eshte kostua ne lek taksat e</p>	<p><b>16.02.2016</b></p> <p>Pershendetje, Referuar pyetjes tuaj, sqarojme:</p>	Perfunduar	Nuk ka	

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>bashkis taksat e regjistrimit gjithsej sa ven ne vit detyrimet + (siguracionet ) pyetja e dyte: per njerzit qe kan komsu te uaj cfar duet dhe a munden ata te kryejn aktivitete</p> <p><b>FALEMINDERIT</b></p>	<p>Ne baze te nenin 22 te Ligjit 9723/2007 “Per QKR” kane detyrim te regjistrohen prane QKR, subjektet si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) subjektet tregtare;</li> <li>b) shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil;</li> <li>c) personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur;</li> <li>ç) zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja;</li> <li>d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;</li> <li>dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;</li> <li>e) çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKR-së.</li> </ul> <p>Ju si fillim duhe te percaktoni formen ligjore te subjektit tuaj.</p> <p>Nese subjekti juaj do te jete person fizik, mjafton te paraqiteni prane cdo sporteli te QKR me document identifikimi (karte identiteti ose pasaporte biometrike), Nese aplikimi behet jo nga administrator, duhet te paraqisni dhe prokure nga noteri per te bere aplikimin.</p> <p>Nese subjekti juaj eshte person juridik duhen dokumente si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Statut dhe akti i themelimi;</li> <li>- Document identifikimi;</li> <li>- Autorizim nga administratori i shoqerise;</li> </ul> <p>Regjistrimi fillestar per nje subjekt/shoqeri mund te behet dhe online ne portalin e-albania . Shiko linkun : <a href="http://www.qkr.gov.al/nrc/Online.aspx">http://www.qkr.gov.al/nrc/Online.aspx</a> .</p> <p>Persa i perket detyrimeve, nuk eshte QKR-ja institucioni kopotent.</p> <p>Cdo person qe ushtron aktivitetin e tij ne Shqiperi, pavaresisht kombesise k ate drejte te regjistrohet prane QKR-se. Per me shume informacion shiko linkun : <a href="http://www.qkr.gov.al/nrc/Udhezime_Bij.aspx">http://www.qkr.gov.al/nrc/Udhezime_Bij.aspx</a> .</p> <p>Faleminderit,</p>		
--	--	---	---	--	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

20	15.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>15.02.2016</b> Referuar email-it tuaj, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Ne rastin konkret eshte mbylluar aplikimi, duke mbyllur faqen e punes (browser-in). Per te vazhduar me aplikimin per nje subjekt tjetër, ju duhet te pastroni historikun e 'browser-it' qe ju perdorni.</p>	Perfunduar	Nuk ka
21	15.02.2016	Ankese	<p><b>15.02.2016</b> Ne vijim te komunikimit, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Siç edhe ju beme me dije nepermjet emailit, QKR, nuk mund te kryeje çregjistrimin, pasi organi tatimor kompetent, konkretisht Bashkia Elbasan, nuk e ka terhequr kundërshtimin per çregjistrimin e tij.</p> <p>Referuar pikes 8 të nenit 45 te ligjit 9920 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, pasi tatimpaguesi ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes dhe ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, gjobat dhe interesat e papaguar, organi tatimor kompetent detyrohet të tërheqë menjëherë kundërshtimin për çregjistrim dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit.</p> <p>Nga sa me siper eshte detyrim i organit tatimor per te terhequr kundërshtimin per çregjistrin, pasi tatimpaguesi ka shlyer te gjitha detyrimet tatimore. Per me teper informacion mund t'i referoheni nenit 45 te ligjit 9920 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.</p>	Perfunduar	Nuk ka
	15.02.2016	<p>Pershendetje ,</p> <p>Dua te bej dorezimin e bilancit te vitit 2015 online, dhe mberrij deri ne pamjen bashkelidhur , ku me kerkohet te shkarkoje Morpho Smart Card.</p> <p>I jap shkarko , Run , plotesohet shkarkim dhe kaq, me rikthen serisht tek faqa e ALEAT .</p>	<p><b>29.02.2016</b></p> <p>Përshëndetje,</p> <p>Lidhur me pyejtjen tuaj, ju bëjmë më dije se,</p> <p>Në faqen zyrtare të QKR konkretisht në linkun <a href="http://www.qkr.gov.al/nrc/Online.aspx">http://www.qkr.gov.al/nrc/Online.aspx</a> gjendet manuali dhe udhëzuesi për aplikimin online. Në Udhëzuesin mbi ofrimin e shërbimeve online në Qendrën Kombëtare të</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>Dhe me doli mesazhi “ Aplikim I derguar I panenshkruar “</p> <p>Cfare duhet te beje ? Faleminderit ,</p>	<p>Regjistrimit gjenden hapat, procedurat dhe pajisjet e nevojshme për të kryer me sukses aplikimin on line në regjistrin tregtar nëpërmjet portalit e-albania.</p> <p>Faleminderit</p>		
16.02.2016	<p>Pershendetje, Deshiroj te shes bizhuteri etj, online. A eshte i nevojshem rregjistrimi ne QKR, a duhet te marr license dhe a duhet te pajisem me kase.Cilat do te jene detyrimet e mia tatimore ? Ju faleminderit</p>	<p><b>26.02.2016</b> Përshëndetje,</p> <p>Lidhur me kërkesën tuaj, sqarojmë se:</p> <p>Të gjitha bizneset tregtare, qofshin këto persona fizikë apo juridikë, të cilët kryejnë një aktivitet ekonomik fitimprurës në Shqipëri, duhet të regjistrohen në QKR.</p> <p>Për sa i përket detyrimeve tatimore për subjektet , sqarojmë se: Neni 4, germa dh) e ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, përcakton se ,QKR ka si funksinon informimin dhe këshillimin vetëm lidhur me procedurat e regjistrimit.</p> <p>Faleminderit!</p>	Perfunduar	Nuk ka	
16.02.2016	<p>Dua te ndryshoj edhe adresen e shoqerise pasi shoqeria tani i ka zyrat ne rrugen myslym shyri.cfare dokumentash me me duhen. Faleminderit per korrektesine</p>	<p><b>26.02.2016</b> Përshëndetje</p> <p>Lidhur me kërkesën tuaj, sqarojmë se:</p> <p>Për ndryshimin e adresës së shoqërisë, duhet të paraqiten dokumentet si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendimi i ortakut ose i asamblesë së ortakëve për ndryshimin e adresës së selisë;</li> <li>2. Autorizimi nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi i shoqërisë (administratori);</li> <li>3. Dokument identifikimi të aplikantit;</li> <li>4. Certifikata e regjistrimit (kartoni i niptit).</li> </ol>	Perfunduar	Nuk ka	

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			Faleminderit,		
23	16.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>23.02.2016</b> Nisur nga emaili juaj, ju bejme me dije se, aplikimi me numer CN-547661-02-16 figuron te jete miratuar.</p> <p>Verifikimin mund ta kryeni ne faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek menu: Sherbime te reja, nenmenu: Kontrolllo statusin e aplikimit per regjistrim, si dhe duke gjeneruar ekstraktin historik.</p>	Perfunduar	Nuk ka
	18.02.2016	<p>Pershendetje, Jam e interesuar te di ne lidhje ne hapjen e nje filiali per nje biznes ekzistues ne nje pike tjeter. Cfare duhet te bej? Duhet te regjistrohet serish, apo te rifreskohen te dhenat? A ka nderlikime tatimore?</p> <p>Faleminderit parapakisht,</p>	<p><b>22.02.2016</b> Pershendetje,</p> <p>Ju bejme me dije se, per hapjen e adreses dytesore, mund te aplikoni prane çdo sporteli sherbimi te QKR-se, por edhe online nepermjet portalit qeveritar e-albania (<a href="http://www.e-albania">www.e-albania</a>). Lidhur me aplikimin online mund te informoheni ne faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek Seksioni: Regjistrimi online; Udhezuesi mbi ofrimin e sherbimeve online ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.</p> <p>Faleminderit,</p>	Perfunduar	Nuk ka
	18.02.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Doja te pyesja si veprohet ne rastin e hapjes se axhensise turistike apo licensimit si guide turistike?</p> <p>Ne te dyja rastet doja te dija si veprohet dhe ku duhet te regjistrohesh? Ka ndonje procedure te vecante per keto dy raste?</p> <p>faleminderit</p>	<p><b>26.02.2016</b> Përsëndetje, Lidhur me kërkesën tuaj, sqarojmë se;</p> <p>Të gjitha bizneset tregtare, qofshin këto persona fizikë apo juridikë, të cilët kryejnë një aktivitet ekonomik fitimprures në Shqipëri, duhet të regjistrohen te QKR.</p> <p>Në bazë të Ligjit Nr. 9723, datë: 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, neni 22, subjektet qe regjistrohen në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKR, janë:</p> <p>a) subjektet tregtare; b) shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil; c) personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur; ç) zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive</p>	Perfunduar	Nuk ka



## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>të huaja;</p> <p>d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;</p> <p>dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;</p> <p>e) çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKR-së.</p> <p>Për sa i përket licensimit mund të merrni informacion me të detajuar në faqen zyrtare <a href="http://www.qkl.gov.al/">http://www.qkl.gov.al/</a></p> <p>Faleminderit!</p>		
24	17.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>23.02.2016</b></p> <p>Referuar emailit tuaj, ju bejme me dije se:</p> <p>Neni 43, i ligjit 9723/2007 "Per QKR", I ndryshuar, citon:          "Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:</p> <p>a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;....."</p> <p>Neni 46, i ligjit të sipërcituar citon:          "1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t'i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.          2. Nëse një subjekt nuk përmbush detyrimin, sipas këtij neni, atëherë QKR-ja, së bashku me zbatimin e sanksionit të parashikuar në pikën 3, të nenit 74, të këtij ligji, vepron në përputhje me parashikimet e shkronjës "ë", të nenit 54, të këtij ligji."</p> <p>Nga sa me sipër, si dhe mbështetur në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a> për dorëzimin e bilanceve, depozitimi i bilanceve në QKR do të bëhet për ato subjekte që e kanë të detyrueshme mbajtjen e tyre, si dhe nëpërmjet aplikimit online (neni 70 i ligjit "Per QKR").</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>Lidhur me aplikimin online, mund te merrni informacion ne faqen zyrtare, tek Seksioni: Regjistrimi online.</p> <p>Gjithashtu, per t'ju dhene informacion lidhur me rastin konkret, duhet te na dergoni te dhenat e aplikimit qe keni kryer.</p>		
	20.02.2016	<p>Pershendetje</p> <p>Nese do te ishte e mundur, kam nevojte te dije nese zyra informacioni apo burime aksesit per te institucioni juaji ndodhen edhe ne qendrat e minibashkive te lagjeve ku jetojme ne Tirane ?</p> <p>Ne pritje te nje pergjigje ju falenderoj, pune te mbare !</p>	<p><b>22.02.2016</b> Pershendetje,</p> <p>Qendra Kombetare e Regjistrimit operon nepermjet sportelit qendror, si dhe ne sportelin prane Bashkise se Tiranës, ne adresat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve,Tiranë;</li> <li>- Rruga "Kavajes" ish Uzina Mekanike, Drejtoria e Tarifave e Taksave, Bashkia Tirane.</li> </ul> <p>Gjithashtu informacion mund te gjeni dhe ne faqen zyrtare te QKR, <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a> .</p> <p>Faleminderit,</p>	Perfunduar	Nuk ka
27	22.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>23.02.2016</b> Nga verifikimi i kryer rezulton se, aktualisht figuron me status: Shoqeri ne Likuidim e Siper.</p> <p>Ky subjekt ka aplikuar per çregjistrim, me aplikimin me numer CN-597340-08-14, aplikim i cili figuron te jete refuzuar me arsyen: "Çështja refuzohet, bazuar në Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për QKR", Neni 57, pasi subjekti nuk ka plotësuar brënda afatit ligjor 15 ditor, elementet që pengojnë regjistrimin, të cilat janë : Në zbatim të nenit 200 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", raporti i likuidimit dhe bilancet e hartuara nga likuidatori i shoqërisë duhet të miratohen nga ortaku i vetëm."</p> <p>Nga sa me siper, duhet te riaplikohet per çregjistrimin e subjektit me dokumentacionin perkates ne perputhje me ligjin.</p>	Perfunduar	Nuk ka
30	23.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>25.02.2016</b> Nisur nga emaili juaj, ju sqarojme se, aplikimi me numer CN-563733-02-16, per depozitim bilanci financiar te vitit 2008,</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>figuron te jete refuzuar pasi mungon formulari i aplikimit i nenshkruar elektronikisht.</p> <p>Ju bejme me dije se, per te kryer aplikimin online per depozitimin e bilancit financiar te vitit 2008, duhet te ndiqni te gjithë hapat sipas udhezimeve dhe informacionit, qe do te gjeni ne faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek Seksioni: Regjistrimi online.</p>		
28	24.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>24.02.2016</b></p> <p>Nisur nga emaili juaj, ju bejme me dije se, referuar nenit 22 te ligjit 9723/2007 "Per QKR", i ndryshuar, ku percaktohen subjektet qe detyrohen te regjistrohen ne QKR, Drejtorite e Sherbimit Spitalor nuk jane subjekte qe detyrohen te regjistrohen ne QKR.</p> <p>Nga verifikimi i kryer, nuk ekziston ne regjistrin tregtar elektronik.</p> <p>Bazuar ne sa me siper, duhet t'i drejtoheni organeve kompetente.</p>	Perfunduar	Nuk ka
29	24.02.2016	Ankese	<p><b>24.02.2016</b></p> <p>Aplikimi me numer CN-567724-02-16, figuron te jete pezulluar me arsyen: "Te depozitohet autorizimi per aplikantin nga administratori i shoqerise."</p> <p>Ne kete aplikim jane paraqitur dokumentet si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendimi i Asamblese se pergjithshme te ortakeve te shoqerise "AFC - Food &amp; Beverages sh.p.k.", per riemerimin e administratorit te shoqerise.</li> <li>- Mandati i pageses per kryerjen e aplikimit</li> <li>- Dokumenti i iedntifikimit te aplikantit</li> <li>- Formulari i aplikimit date 22.02.2016</li> </ul> <p>Sqaroj se, shqyrtimi i aplikimit te sipercituar eshte kryer ne perputhje me nenin 54 te ligjit 9723, date 03.05.2007 "Per QKR", i ndryshuar dhe eshte pezulluar konform nenit 56 te ketij ligji, pasi eshte konstatuar se, nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim dhe konkretisht: Aplikuesi qe ka kryer aplikimin nuk eshte perfaqesuesi ligjor i shoqerise dhe as person i autorizuar prej tij.</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>Neni 26, pika 3, e ligjit të sipercituar 9723/2007 “Per QKR”, i ndryshuar, percakton se: “Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre.”</p> <p>Gjithashtu, ju bej me dije se, neni 95 i ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” te cilit i referohet ankuesi ne email, ka ndryshuar me Ligjin Nr.129/214 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” te ndryshuar, i cili ne nenin 15 te tij citon: Ne nenin 95 behen ndryshimi dhe shtesa e meposhtme: 1. Ne piken 1, fjalia e trete ndryshohet si me poshte: "Emerimi i administratoreve, i cili hyn ne fuqi ne daten e percaktuar sipas aktit te emerimit, u kundrejtohet paleve te treta sipas percaktimeve te nenit 12 te ketij ligji."</p> <p>Nga sa me siper, pezullimi i aplikimit me numer CN-567724-02-16 eshte kryer konform ligjit, duke i dhënë aplikuesit një afat prej 21ditësh kalendarike për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin.</p>		
31	24.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>25.02.2016</b> Nisur nga emaili juaj, ju sqarojme se, depozitimi i bilanceve kryhet vetem nëpërmjet aplikimit online në portalin qeveritar e-albania.</p> <p>Gjithashtu, ju bejme me dije se, QKR nuk eshte institucioni qe administron portalin e-albania.</p> <p>Lidhur me problemin qe keni hasur duhet t'i drejtoheni AKSHI-t per resetimin e password-it. Gjithashtu mund te ndiqni udhezimet dhe informacionin e publikuar ne portalin e-albania.</p>	Perfunduar	Nuk ka
	24.02.2016	Përsëndetje Folëm në telefon sot dhe unë të kërkuar për të ju pyes se sa të fillojë -up kapitalit për të hapur një kompani të re në Shqipëri ???	<p><b>26.02.2016</b> Përsëndetje,</p> <p>Lidhur me pyetjen tuaj, sqarojmë se:</p> <p>Bazuar në Nenin 70 te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Për</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>tregtarët dhe shoqëritë tregtare”(i ndryshuar) Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k) nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 100 lekë.</p> <p>Ndërsa për sa i përket shoqërisë aksionare(Sh.A) me ofertë private, neni 107, pika 1 i ligjit të sipërcituar parashikon se nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë.</p> <p>Faleminderit!</p>		
	25.02.2016	Kerkese per informacion	<p><b>29.02.2016</b></p> <p>Nisur nga emaili juaj, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas ligjit, regjistron në regjistrin tregtar dhe publikon të dhënat në faqen zyrtare të internetit <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, lehtësisht të aksesueshme , ku mund të gjeni informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për çdo subjekt, në kohë reale.</p> <p>Konkretisht, kerkimin mund ta kryeni ne faqen zyrtare <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek menu: Kerko per subjekt, ku kerkimi mund te kryhet sipas udhezimeve dhe mbi bazen e te dhenave të percaktuara ne kete Menu.</p>	Perfunduar	Nuk ka
	25.02.2016	<p>Pershendetje</p> <p>Ju lutem doja te dija per te bere kërkesën per te kaluar biznesin inaktiv (passive) per nje periudhe te papërcaktuar, mund te paraqitet nje person i autorizuar me prokure nga administratori i kompanisë?</p> <p>Dhe nese eshte e mundur çfarë dokumentash duhet per te bere kete aplikim pranë sporteveleve tuaja?</p> <p>Ju faleminderit</p>	<p><b>26.02.2016</b></p> <p>Përshëndetje,</p> <p>Lidhur me pyetjen tuaj, sqarojmë se:</p> <p>Në nenin 44, pika ç të ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, parashikohet se subjektet mund të regjistrojnë vendimet e pezullimit të veprimtarisë. Me regjistrimin e vendimit apo kërkesës për pezullimin e veprimtarisë, statusi i subjektit në regjistrin tregtar shënohet “Pezulluar”.</p> <p>Për të kryer aplikimin për pezullimin e aktivitetit tregtar, duhet të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm :</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kërkesa / vendimi për pezullimin e aktivitetit tregtar;</li> <li>2. Autorizimi nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi i shoqërisë (administratori);</li> <li>3. Certifikata e regjistrimit (kartoni i niptit);</li> <li>4. Dokumenti i identifikimit të aplikantit.</li> </ol> <p>Faleminderit!</p>		
25.02.2016	Komunikim i Vendimit të Gjykesës së Rrethit Gjyqësor Korçë	<p><b>29.02.2016</b></p> <p>Ne pergjigje te emailit tuaj, ju sqarojme si me poshte:</p> <p>Referuar nenit 20 te ligjit nr.9723/2007 “Per QKR”, i ndryshuar, regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKR-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit.</p> <p>Gjithashtu, ju bejme me dije se, bazuar ne nenin 70 te ligjit 9723/2007 “Per QKR”, i ndryshuar, QKR ka mundesuar edhe aplikimin online per regjistrimin e vendimeve/akteve te gjykates dhe autoriteteve te tjera publike. Per me teper informacion, lidhur me aplikimin online per regjistrimin e vendimeve/akteve te gjykates, mund te klikoni ne linkun: <a href="http://www.qkr.gov.al/nrc/Online.aspx">http://www.qkr.gov.al/nrc/Online.aspx</a></p> <p>Ne menyre qe, QKR te kryeje kryesisht regjistrimin e vendimit te gjykates, sipas nenit 45 te ligjit te sipercituar, duhet te dergoni sa me shpejt zyrtarisht (me poste) kete vendim ose te aplikoni online.</p>	Perfunduar	Nuk ka	
26.02.2016	Ankese	<p><b>29.02.2016</b></p> <p>Aplikimi per çregjistrim me numer CN-488142-01-16, i kryer per subjektin tuaj (person fizik) me figuron te jete refuzuar me arsyen si me poshte:</p> <p>“QKR nuk mund të çregjistrojë subjektin, nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit, ne baze e per zbatim te Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe Ligjit Nr.9920, datë 14.05.2008, "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 45.Çështja refuzohet, pasi sipas shkresës nr.1753, datë 05.02.2016, ardhur nga Drejtoria</p>	Perfunduar	Nuk ka	

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>Rajonale Tatimore Sarande, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoha apo interesa të papaguara me vlerë 29700 lekë.”</p> <p>Verifikimin, mund ta kryeni ne faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek menu: Sherbime te reja, nenmenu: Kontrolllo statusin e aplikimit per regjistrim, si dhe duke gjeneruar ekstraktin historik.</p>		
		<p>Se pari, mbeshtetur ne nenin 26/3 te Ligjit 9723, date 03.05.2007 “Per regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre.</p> <p>Gjithashtu ju bejme me dije se, shqyrtimi i aplikimeve kryhet nga QKR mbeshtetur ne nenin 54 te ligjit, ku percaktohet:</p> <p>“QKR-ja asiston aplikantin në plotësimin e aplikimit dhe verifikon:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;</li><li>b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;</li><li>c) paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;</li><li>ç) faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënat që përmbajnë dokumentet, që shoqërojnë formularin;</li><li>d) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik;</li><li>dh) nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet;</li><li>e) pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim;</li><li>ë) faktin nëse aplikuesi ka shlyer sanksionet administrative të dhëna dhe ka kryer regjistrimet e kërkuara sipas nenit 46.</li></ul> <p>.....</p> <p>QKR-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, që I bashkëlidhen aplikimit për regjistrim apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi.....</p> <p>QKR-ja është e detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim, të paraqitur sipas këtij ligji dhe dokumentet që i bashkëlidhen, edhe nëse aplikimi është i paplotë, apo dokumentet shoqëruese të pasakta.”</p> <p>Sa me sipër, QKR do te shqyrtoje aplikimin e kryer konfom</p>	
--	--	---	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			dispozitave ligjore ne fuqi.		
18.04.2016	Kam bere nje kerkese per vendosjen e nje kontatori elektrik ne nje ambient prej 33 meterkatror qe eshte gjysma e nje ambienti qe kur ishte i pandare figuronte si dyqan ne te cilin eshte vendosur nje kontator i berbashket.Kete ambient e ndame dhe pjesa ime eshte sa gjysma tij dhre tani une dua te ve nje kontator te vecante sepse ai kontator qe u vendos vitin qe shkoi eshte ne pjesen e vellait tim nga i cili tani per tani furnizohem dhe une.Godina eshte e re dhe perfundoi ne veren e vitit te kaluar.Oshee Himare pervec dokumentave te tjera do dicka edhe nga Ju.Ky i ashtuquajhuri dyqan nuk perdoret per kete qellim, po ne kemi vendosur aty nje lavatrice per te lare dhe ndonji mayerial tjetet.Ju lutem me thoni si duhet te veproj.	<b>21.04.2016</b> Përshëndetje,  Lidhur me kërkesën tuaj, sqarojmë se; Të gjitha bizneset tregtare, qofshin këto persona fizikë apo juridikë, të cilët kryejnë një aktivitet ekonomik fitimprures në Shqipëri, duhet të regjistrohen te QKB.  Në bazë të Ligjit Nr. 9723, datë: 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, neni 22, subjektet qe regjistrohen në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKR, janë:  a) subjektet tregtare; b) shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil; c) personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur; ç) zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja; d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit; dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë; e) çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKR-së.  Per me shume informacion vizitoni faqen tone zyrtare <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a> .  Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka	
18.04.2016	Pershendetje,  kompania jone SHPK kerkon te beje zmadhim kapitali ne para e cila do mundesohet nga shtimi i dy ortakeve te rinj. Cila eshte rruga qe duhet te ndjek duke qene se :  1. Do me ndryshoje numri i ortakeve	<b>21.04.2016</b> Pershendetje,  Referuar pyetjes tuaj, sqarojme:  Per te kryer aplikimin per zmadhimin e kapitalit ne para, per nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, shpk, duhen dokumentet si me poshte:  <b>1.</b> Vendimi i ortakut ose i asamblese se ortakeve për zmadhimin e kapitalit ne para.	Perfunduar	Nuk ka	

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>2. Do me zmadhohet kapitali</p> <p>Faleminderit,</p>	<p><b>2.</b> Lista e personave qe kane nenshkruar kuota se bashku me shumate e paguara. Lista nenshkruhet nga administratori/ret.</p> <p><b>3.</b> Nqs se aplikimi nuk kryhet nga administratori, por nga nje përfaqesues aplikanti duhet të paraqesë autorizimin nga administratori.</p> <p><b>4.</b> Dok.Identifikimi i aplikantit ose personit te autorizuar, shtetas shqiptar (leternjoftim elektronik;karte identiteti, pasaport biometrike).</p> <p>Per me shume informacion, vizitoni faqen tone zyrtare <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a> .</p> <p>Faleminderit,</p>		
	18.04.2016	Kerkese per informacion	<p><b>20.04.2016</b></p> <p>Ne pergjigje te emailit tuaj, ju sqarojme se, aplikimet per cregjistrim per subjektet e permendura ne emailin tuaj jane miratuar.</p> <p>Verifikimin lidhur me gjendjen e aplikimit te kryer, mund ta kryeni ne faqen zyrtare: <a href="http://www.qkr.gov.al">www.qkr.gov.al</a>, tek menu: Sherbime te reja, nenmenu: Kontrolllo statusin e aplikimit per regjistrim, si dhe duke gjeneruar ekstraktin historik.</p>	Perfunduar	Nuk ka
	20.04.2016	<p>E/I nderuar,</p> <p>Une jam perfaqesues I Odes Ekonomike te Kosoves (OEK) per Shqiperine.</p> <p>Ne vazhdim te takimeve qe Kryeministri Rama dhe Ministrat e Finances e Ekonomise kane pase me bizneset nga Kosova dhe ne vazhden e rritjes se bashkepunimit mes dy vendeve, OEK do ta zgjeroje aktivitetin e saj ne Shqiperi ne mbeshtetje te bizneseve ekzistuese dhe me synimin qe te inkurjaoje</p>	<p><b>21.04.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Ju bëjmë me dije se, QKB, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Me qëllim shkurtimeve të kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>investiture tjere nga Kosova per te filluar aktivitetin ne Shqiperi.</p> <p>Si hap I pare do te na duhej ndihma juaj per te marre te dhenat e bizneseve me orgjine nga Kosova te regjistruara ne Republiken e Shqiperise. Ju lutem na beni me dije proceurat qe duhet te ndiqen per kete.</p>	<p>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).</p> <p>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.</p> <p>Faleminderit,</p>		
01	03.05.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Dua te aplikoj online per regjistrim fillestar person fizik, por ne momentin qe klikoj tek "Apliko" me del error dhe tabela bashkangjitur</p>	<p><b>04.05.2016</b> Pershendetje,</p> <p>Referuar kerkeses tuaj, sqarojme si me poshte:</p> <p>Marrja e shërbimeve publike të qeverisjes elektronike nëpërmjet portalit qeveritar dhe/ose sistemeve të tjera elektronike nga çdo përdorues, person fizik ose juridik, kalon në procesin e autentifikimit dhe identifikimit për garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në ofrimin e shërbimeve individuale.</p> <p>Persa me siper, lutem perdorni browserin “Google Chrome” per te bere te mundur aplikimin qe kerkoni.</p> <p>Per me shume informacion, vizitoni faqen tone zyrtare <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a> dhe ne adresen <a href="http://www.e-albania.com">www.e-albania.com</a></p>	Perfunduar	Nuk ka
02	03.05.2016	<p>Pershendetje</p> <p>Jam informuar nga faqja juaj per detyrimin ligjor per dorezimin e pasqyrave financiare si çdo biznes tjetër.</p> <p>Kerkoj ndihmen tuaj per</p>	<p><b>05.05.2016</b> Pershendetje,</p> <p>Referuar pyetjes tuaj, sqarojme:</p> <p>Portali unik qeveritar <a href="http://e-albania.al">e-albania.al</a> administrohet dhe zhvillohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së</p>	Perfunduar	Nuk ka



## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>çbllokimin e llogarise time ne faqen e-albania, sepse nuk arrij te rregjistrohem. Ne pritje te ndihmes tuaj</p>	<p>Informacionit,  Ndryshimi i Passwordit, apo cdo veprim qe lidhet me portalin e-albania kryhet nga administratorët e portalit e-albania. Per cdo paqartesi vizitoni faqen zyrtare <a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania .al</a>.</p>		
03	07.05.2016	<p>Pershendetje! A eshte e mundur depozitimi i bilanceve te vitit 2015.Jam munduar te bej depozitim dhe nuk mundem pasi me del si me poshte ? Ju lutem me ktheni pergjigje, pasi duam te levizim per arsye familjare.</p>	<p><b>10.5.2016</b>  Pershendetje, Referuar kerkeses tuaj, sqarojme: Depozitimi i pasqyrave financiare, raporteve të auditit dhe ecurisë së veprimtarisë për vitin financiar 2015, mundësohet vetëm nëpërmjet aplikimit online në portalin qeveritar e-albania (<a href="http://www.e-albania.com">www.e-albania.com</a>).  Ky shërbim mund t'i ofrohet vetëm një subjekti/biznesi që është i regjistruar tashmë në QKB. Subjekti (tashmë i regjistruar) akseson nga “workspace” i tij, shërbimin elektronik të depozitimit të bilancit dhe bën aplikimin.  Lutem, perdorni browserin “Google Chrome” per te bere te mundur aplikimin per depozitimin e bilanceve.  Bashkelidhur, gjeni manualin per depozitimin e pasqyrave financiare.  Per me shume informacion, vizitoni faqen tone zyrtare <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a> ose adresen <a href="http://www.e-albania.com">www.e-albania.com</a>.</p>	Perfunduar	Nuk ka
04	03.05.2016	<p>Kisha nje pyetje nese mund te me jepni nje informacion ju lutem.... Nese jam duke hapur nje subjekt i cili ka dy ortak, dmth une dhe nje tjetet, rregjistrimin ne cilin emer do e bej? Niptin ne cilin emer do</p>	<p><b>29.05.2016</b> Përshëndetje,  Referuar pyetjeve të parashtruara nga ana Juaj, ju sqaromë si më poshtë vijon:</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>e hap? Flm :)</p>	<p>Koncepti i shoqërive tregtare, përcaktohet në nenin 3, pika 1, e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ku citohet se: “Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm)”.</p> <p>Në vijim, sqarojmë se, sipas pikës 2 të nenit të sipërcituar, shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.</p> <p>Sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 9723, për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare është e detyrueshme deklarimi i emrit të shoqërisë (neni 32 i këtij ligji). Emri i shoqërisë nuk është I lidhur me ortakët e shoqërisë.</p> <p>Shoqëritë tregtare e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën emrin e regjistruar. Emri i shoqërisë tregtare duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 23 të ligjit nr.9723, ku përcaktohet se, ndaloher regjistrimi në regjistrin tregtar i subjekteve me emra të njëjtë ose të ngjashëm, me emra në trajtën e shquar apo shkurtimet përkatëse të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emra, që janë në kundërshtim me rendin e moralin publik apo me dispozitat urdhëruese të ligjit.</p> <p>Sa më sipër, me numër unik identifikimi (NUIS), pajiset shoqëria, me emrin e përzgjedhur dhe</p>		
--	--	----------------------	---	--	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			përcaktuar në aktet e shoqërisë dhe jo ortakut.		
04	12.04.2016	Subjekti Kristalina - kh ,pyesim vendimi i ortakut te vetem te shoqerise per shtyrjen e afatit te rizgjedhjes se Administratorit munde te dergohet on-line apo ne menyre manuale.Pune te mbare	<p><b>11.05.2016</b></p> <p>Lidhur me pyetjen Tuaj, ju sqarojmë, si më poshtë vijon:</p> <p>Referuar nenit 20 te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit.</p> <p>Aplikimi mund të kryhet edhe nëpërmjet sporteli elektronik në portalin e-albania.</p> <p>Gjithashtu, ju bëjmë me dije, se në faqen zyrtare të QKB-së <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a> , mund të gjeni të gjitha instruksionet dhe dokumentet e nevojshme për kryerjen e aplikimit.</p> <p>Faleminderit,</p>	Perfunduar	Nuk ka
06	10.05.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Kam Aplikuar per regjistrim te vendimit te asamblese per miratim te bilancit vjetor si dhe miratimin e caktimit te ekspertit kontabel per vitin 2016 si dhe per rritjen e kapitalit, dhe pas dy pezullimesh per plotesim dokumentacioni (dje I fundi), sot statusi I Aplikimit me rezulton I paplote dhe pa asnje arsye. Bashkelidhur gjeni Arsyet e pezullimit te publikuara ne faqen tuaj, te cilat jane bosh.</p>	<p><b>18.05.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Ne pergjigje te e-mail tuaj ju bejme me dije se, aplikimi me numer ceshtje Cn-679700-05-16, eshte miratuar.</p> <p>Faleminderit</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>Ju lutem me ktheni nje pergjigje sa me shpejt pasi pas kesaj praktike me duht te depozitoj bilancin vjetor ne sistemin online por duke qene se kjo praktike eshte e hapur nuk mundem ta kryej.</p>			
08	20.05.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Eshte kryer prane QKR KORCE 8.2.2016 dhe ne sistem ka statusin per likuidim.</p> <p>Ju lutem kerkoj keto sqarime..</p> <p>1-Subjekti eshte biznes i vogel me xhiro nen 8 milion lek por me status juridik                  duhet qe per tu cregjistruar te ndjeke rrugen me likuidator, nuk ka asete, gjendje magazine 0, vetem kapitalin 10.000 lek</p> <p>2-Ne daten 22.2.2016 dergoj me poste lajmerimin e pare per tu botuar ne faqe te qkr, diponohet vetem faturen e postes qe po ju dergoj, por ne faqe nuk eshte botuar                  ( per kete po lajmeroj tani se nuk e dija qe duhej te kontrolloja)</p> <p>3-Mbas 1 muaji nuk kam bere lajmerim te dyte se nuk e dija. ju sqarohet se ky subjekt nuk ka detyrime ne bilanc 2015,po aplikon per mbyllje qe ne janar 2016, nuk ka kreditore nga te cilet mund te priten reklamime.</p>	<p><b>25.05.2016</b>                  Përsëndetje,</p> <p>Lidhur me pyetjen tuaj, sqarojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Për personat juridikë çregjistrimi në mënyrë vullnetare kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim dhe depozitimit të akteve përkatëse, që vërtetojnë kryerjen dhe mbylljen e procedurave të likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Legjislacioni nuk parashikon raste përjashtimore për sa i përket xhiros apo gjendjes së aktivitetit të shoqërisë.</p> <p>Çregjistrimi vullnetar për personat juridikë, bazuar në nenet 190 - 203 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, kalon në dy faza:</p> <p>FAZA E PARË - Fillimi i procedurës së likuidimit/emërimi i likuidatorit</p> <p>Dokumentacioni shoqëruar për aplikim në QKB:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dokumenti i identifikimit të përfaqësuesit ligjor/likuiduesit (nëse ai është aplikanti).</li> <li>- Nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor/likuiduesi, duhet të depozitohet Akti i Përfaqësimit.</li> <li>- Vendimi i Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë për fillimin e procedurës së likuidimit ose Vendimi i gjykatës për caktimin e likuiduesit sipas nenit</li> </ul>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>JU LUTEM me ndihmoni me informacion si duhet te vazhdoj ne kete moment.</p> <p>Faleminderit</p>	<p>191/2 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshaur.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë.</li> <li>- Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre (neni 194 i ligjit nr.9901/2008).</li> <li>- Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.</li> </ul> <p>Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimi “Në likuidim”. Likuiduesit duhet të ftojnë 2 herë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Ftesat drejtuar kreditorëve, duhet të publikohen në faqen zyrtare të QKB (neni 195 i ligjit nr. 9901/2008).</p> <p>Pasi është regjistruar fillimi i procedurave të likuidimit, përpara se të kryejë çregjistrimin e subjektit, në përputhje me ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 45, nëpunësi i autorizuar (regjistruesi), detyrohet të njoftoje organet tatimore dhe të presë brenda afatit ligjor 30 dite kalendarike, konfirmimin ne lidhje me situaten tatimore të subjektit (ka apo jo detyrime).</p> <p>FAZA E DYTË - Çregjistrim i personit juridik (Çregjistrimi i personit juridik nuk mund të bëhet përpara përfundimit të afatit për depozitim e pretendimeve të kreditorëve (ligji 9901/2008, i ndryshuar, neni 199 pika 1).</p> <p>Dokumentacioni shoqërues për aplikim në QKB:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dokumenti i identifikimit të likuiduesit (nëse ai është aplikanti).</li> <li>- Nëse aplikanti është i ndryshëm nga likuiduesi, duhet të depozitohet Akti i Përfaqësimit.</li> <li>- Bilanci i gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe bilanci përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. (neni 198)</li> </ul>		
--	--	--	--	--	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>- Raporti i likuidatorit për procedurën e likuidimit.          - Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për miratimin e raportit të likuidimit dhe lirim in e likuiduesve nga detyra.</p> <p>Çregjistrimi nuk kryhet nëse aktet e ndërmjetme të procesit të likuidimit nuk janë njoftuar dhe depozituar pranë Regjistrisë Tregtar.</p> <p>Nga verifikimi nuk rezulton që për subjektin HEARING ASSISTIVE TECHNOLOGY ALBANIA identifikuar me NUIS (NIPT) L53823001I, të jetë paraqitur pranë QKB njoftimi drejtuar kreditorëve.</p> <p>Jeni të lutur të kryeni dërgimin e Ftesës drejtuar kreditorëve, në përputhje me nenin 195 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.</p>		
11	17.05.2016	<p>Pershendetje          Kam qellim te hap nje biznes Call-Center,dergova nje mikun tim per te bere regjistrimin ne QKR por gabimisht regjistrimi eshte bere si Person Fizik nderkohe qe doja ta regjistroja si SHPK.</p> <p>A mund te vazhdoj si person fizik dhe te bej ndryshim me vone ne shpk? Apo te mbyll kete regjistrim dhe te bej regjistrim te ri si shpk? Nese mund te me ndihmoni me nje pergjigje Faleminderit</p>	<p><b>17.05.2016</b>          Lidhur me pyetjen tuaj, ju sqarojmë se</p> <p>PersoNi fizik sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm vlerësohet tregtar dhe ky subjekt është ngushtësisht i lidhur me personin fizik. Tregtari regjistrohet sipas neneve 28 pika 1 dhe 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Tregtari e humbet statusin e tij kur pushon ushtrimin e veprimtarisë ose kur është i detyruar ta pushojë atë. Në një rast të tillë ai çregjistrohet nga regjistri, në përputhje me nenet 48 deri në 53 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Ndërkohë, shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>aksionar të vetëm).</p> <p>Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit të sipërcituar, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.</p> <p>Neni 4 i Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, përcakton se: <i>“Tregtari dhe shoqëritë tregtare e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën emrin e regjistruar. Emri i tregtarit është emri i tij, sipas nenit 5 të Kodit Civil, i regjistruar në përputhje me nenin 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Emri i shoqërisë tregtare duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 23 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit".</i></p> <p>Për sa më sipër, nuk mund të bëhet kalimi nga personi fizik në person juridik (shoqëri tregtare).</p>		
04.05.2016	Pershendetje,	<p>Subjekti VISKOL-AL me NIPT L51727011F eshte ne process likuidimi. Deri tani jemi ne fazen e dyte ku kemi dorezuar ne date 11.04.2016 Ftesen e dyte per kreditorët.</p> <p>1. Sa kohe pas dorezimit te fteses se dyte mund te vijoje me procedure e dorezimit te dokumentave:</p> <p>-Bilanci i gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe bilanci përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. (neni 198)</p> <p>- Raporti i likuidatorit për procedurën e likuidimit.</p>	<p><b>05.05.2016</b></p> <p>Përsëndetje,</p> <p>Referuar pyetjeve të parashtruara nga ana Juaj, sqaromë si më poshtë vijon:</p> <p>Sipas parashikimeve të nenit 199, pika 1, e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, likuiduesi nuk mund te shperndaje aktivet e mbetura te shoqerise perpara perfundimit të afatit të depozitimit të pretendimeve të kreditorëve, të përcaktuar sipas nenit 195 të këtij ligji.</p> <p>Ndërkohë, neni 195, përcakton qartazi se, likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për miratimin e raportit të likuidimit dhe lirimin e likuiduesve nga detyra.</p> <p>2. Bilanci përfundimtar në castin e mbylljes së procedurave ciles date i referohet?</p> <p>Ju lutem me ktheni një përgjigje për të dyja pyetjet me sipër.</p>	<p>interval prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, nëse ka, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.</p> <p>Nisur nga parashikimet e sipërcituara, bilanci përfundimtar i mbylljes së procedurave dhe vijimi me procedurën e dorëzimit të dokumenteve, mund të realizohen minimalisht, 30 ditë pas publikimit të njoftimit të detyrës drejtuar kreditorëve.</p> <p>Likudatorit i shoqërisë, pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura dhe përfundimit të likuidimit, kërkon rregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me Ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", ndryshuar.</p> <p>Faleminderit,</p>		
18	05.05.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Dua të aplikoj online për regjistrim fillestar person fizik, por në momentin që klikoj tek "Apliko" më del error dhe tabela bashkangjitur</p>	<p><b>05.05.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Referuar kërkesës tuaj, sqarojmë si më poshtë:</p> <p>Marrja e shërbimeve publike të qeverisjes elektronike nëpërmjet portalit qeveritar dhe/ose sistemeve të tjera elektronike nga çdo përdorues, person fizik ose juridik, kalon në procesin e autentifikimit dhe identifikimit për garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në ofrimin e shërbimeve individuale.</p> <p>Përsa me sipër, lutem përdorni browserin "Google Chrome" për të bërë të mundur aplikimin që kerkoni.</p> <p>Për më shumë informacion, vizitoni faqen tonë zyrtare <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a> dhe në adresën <a href="http://www.e-albania.com">www.e-albania.com</a></p> <p>Faleminderit,</p>	Perfunduar	Nuk ka



## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

19	18.05.2016	<p>Me ane te ketij e-mail deshiroj tju percjelle kerkesen e shoqerise Bota e Veres shpk per mundesine informimit, per qellimit te promovimit te produkteve tona ndaj subjekteve tregtare klientet tane potencial.Shoqeria Bota e Veres shpk eshte regjistruar me numer unik K01711001E dhe zhvillon aktivitetin e saj ne fushen e shitjes me shumice dhe pakice te vererave te ndryshme te nje cilesie te larte importi! Produktet tona blihen nga disa kantina te njohura ne Itali.</p> <p>Ne kuader te promovimit dhe zgjerimit te klienteve tane, ne kushtet dhe zhvillimeve te reja ekonomike do te ishte nje ndihme shume e madhe per ne infomimi per listen respektive te subjekteve tregtare kryesisht ne fushen e sherbimeve te restorantit,hoteleve, bare kafe dhe vecanerisht atyre qe lidhen me fushen e turizmit.Per kete po i derjtohem institucionit tuaj per mundesit e marrjes se listes se ketyre subjekteve tregtare dhe informimit ne vijim per subejktet qe krijohen rishtazi.</p> <p>Ju lutemi nese plotesimi i kesaj kerkese eshte i pa mundur dhe bie ndesh me kuadrin ligjor ose regulloret e tjera te brendshme te instutucionit tuaj ose nese kjo kerkese administrohet nga</p>	<p><b>20.05.2016</b> Lidhur me informacionin e kerkuar nga ana Juaj, ju sqarojme si më poshtë:</p> <p>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.</p> <p>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).</p> <p>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.</p>	Perfunduar	Nuk ka
----	------------	---	---	------------	--------

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>institucione te tjera do ta vleresonim maksimalisht pergjigjen tuaj nese kjo kerkese eshte brenda kornizave ligjore. Nese duhet te njekim ndonje procedure tjeter ose te derjohemi ne organet e tjera ju lutemi na infomoni ne kete adrese.</p> <p>Duke ju vlersuar per bashkpunimin gjejme rastin te shprehim konsideratën tone me te larte!</p>			
13	24.05.2016	<p>Pershendetje jam duke provuar te dorezoj Bilancin e Vitit 2015 dhe kur shkoj te opsioni "Depozitimi i bilancit vjetor ne Qendren Kombetare te Regjistrimit", me shfaqet shenimi qe po ju dergoj me doc. Cfare do te thote?? Ju lutem, pres pergjigje.</p>	<p><b>30.05.2016</b> Pershendetje,</p> <p>Ju bej me dije se, eshte rregulluar problemi per sherbimin "<i>Depozitimi i bilancit vjetor ne Qendren Kombetare te Biznesit</i>"</p> <p>Faleminderit</p>	Perfunduar	Nuk ka
	31.05.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>A eshte e mundur qe nga te dhenat e QKR mund te marrim informacionin e meposhtem per shoqerite: Hako, Tona, KMY, EHW, Fix, ERDA,KAZAZI etc, qofte edhe kundrejt pageses se sherbimit.</p> <p>Informacioni i kerkuar per 3-5 vietet e fundit eshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Xhiro vjetore</li> <li>· Numri i punonjesve</li> <li>· Pjesa qe ze ne treg</li> </ul>	<p><b>03.06.2016</b> Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se:</p> <p>Bazuar në ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, informacioni i kërkuar nga ju për, më konkretisht xhiro vjetore, numri i punonjesve dhe pjesa qe ze ne treg, nuk disponohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ndaj nuk mund të ofrohet si shërbim as përkundrejt pagesës.</p> <p>Ndërkohë përsa i përket çdo info tjetër tregtare, ju lutem të përcaktoni llojin e informacionit të kërkuar në mënyrë që tju japim një përgjigje më të plotë.</p>	Perfunduar	Nuk ka

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>Dhe cdo info tjetër tregtare.</p> <p>Mbetem ne pritje te nje konfirmimit nga ana e juaj.</p>	<p>Sqarojme se Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.9723/ 2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Me qëllim shkurtimeve të kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.</p> <p>Për përfundimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).</p> <p>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.</p> <p>Faleminderit</p>		
31.05.2016		<p>ju lutem kerkoj nje inform ? jam nje subjekt qe jam regjistru ne date 12/05/2016 ne QKR,cfar detyrimesh me lindin per vete Bashkin,kur aktivitetin e ushtroj ne Pez helmes?</p>	<p><b>03.06.2016</b></p> <p>Lidhur me pyetjen e parashtruar nga ana Juaj, ju sqarojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Qendra Kombëtare e Biznesit, krijuar me Ligjin Nr.131/ 2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, është institucioni i vetëm përgjegjës dhe që shërben si sportel me një ndalesë, për regjistrimin e biznesit dhe të licencave, autorizimeve dhe lejeve në Shqipëri, duke përfshirë dhe regjistrimin për efekt</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>të taksave në nivel kombëtar dhe vendor, sigurimin shëndetësor e shoqëror dhe inspektoratin e punës.</p> <p>Subjektet, në momentin e regjistrimit fillestar regjistrohen edhe për efekt të taksave vendore. Rregullimi i detyrimeve të taksave vendore realizohet në përputhje me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.</p> <p>Njësitë vendore (të konstituara dhe me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativoterritoriale, të përcaktuar në Ligjin Nr.115/2015 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”) i ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre fiskale për taksat vendore, në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e çdo akt tjetër detyruar për sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Për informacion mbi taksat vendore, mund të drejtoheni pranë organeve tatimore përkatëse.</p> <p>Faleminderit,</p>		
	30.05.2016	<p>Jam adimistratore prane kompanise MARISA &amp; LUJ" SH.P.K,jam marre kryesisht me prodhimin e materialit Gips,kam qysh ne vitin 2012 qe nuk zhvilloj asnje aktivitet.</p> <p>Kerkoj nga ana juaj ta mbyll firmen per nje periudhe gjashte mujore derisa te jem gati per te rifilluar serish.</p> <p>Dua te shmang gjobat qe vazhdojne te vijne per Kompanine time.</p> <p>Ju lutem me ktheni nje pergjigje sa me shpejt.</p>	<p><b>03.06.2016</b></p> <p>Lidhur me pyetjen e parashtruar nga ana Juaj, ju sqaromë si më poshtë:</p> <p>Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, neni 44, parashikon se, subjektet mund të regjistrojnë vullnetarisht çdo të dhënë tjetër, që ka lidhje me aktivitetin e tyre ekonomik tregtar. Këto të dhëna shtesë përfshijnë, por pa u kufizuar në, :Vendimet e organeve drejtuese të subjektit, si <b>vendimet e pezullimit të veprimtarisë</b> apo vendimet e tjera të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim.</p> <p>Aplikimi për pezullimin e veprimtarisë mund të kryhet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, duke</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>depozituar dokumentacionin shoqërues:</p> <p>Vendimi i Asamblesë/ ortakut të vetëm për pezullimin e aktivitetit ose kërkesë të administratorit (duke përcaktuar kohëzgjatjen e pezullimit);                  Dokumeti i identifikimit të Përfaqësuesit ligjor (nëse ai është aplikanti).                  Nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor, duhet të depozitohet akti i përfaqësimit.</p> <p>Faleminderit,</p>		
	31.05.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Ju lutemi , per nje informacion se si duhet te procedojme per te bere modifikim ne pershkrimin e objektit te aktivitetit.</p> <p>Faleminderit paraprakisht</p>	<p><b>03.06.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Referuar kerkeses tuaj, sqarojme si me poshte vijon:Së pari, sqarojmë se, dokumentacioni shoqërues i nevojshëm për ndryshimin e objektit të veprimtarisë, është i përcaktuar në varësi të formës ligjore të subjektit (person fizik apo juridik).Në rast subjekti është regjistruar si person fizik, për ndryshimin e objektit të veprimtarisë, nevojitet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dokumenti i identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë biometrike) të aplikantit;</li> <li>• Nëse aplikanti është i ndryshëm nga vetë subjekti, duhet të depozitohet akti i përfaqësimit. Në këtë rast, akti i përfaqësimit duhet të jetë konform parashikimeve të nenit 72 të Kodit Civil.</li> </ul> <p>Nëse subjekti është regjistruar si person juridik, nevojiten:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendimi i asamblesë/ ortakut të vetëm për ndryshimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.</li> <li>• Dokumeti i identifikimit të përfaqësuesit ligjor (nëse ai është aplikanti).</li> </ul>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<ul style="list-style-type: none"> <li>Nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor, duhet të depozitohet akti i përfaqësimit.</li> </ul> <p>Aplikimi mund të kryhet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, ose nëpërmjet sportelit elektronik, në platformën e-albania. Për më shumë informacion mund të vizitoni faqen zyrtare të QKB-së, <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a> Faleminderit,</p>		
	03.06.2016	<p>Pershendetje</p> <p>Ne lidhje me dorezimin e bilancit,Referuar :</p> <p>1..Ligji Nr. 9723, datë: 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar;</p> <p>2. VKM Nr. 506, datë: 01.08.2007, “Për Procedurat e Regjistrimit dhe të Publikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Sipas Ligjit per QKR,</p> <p>Deget apo Zyrat e Perfaqesimit, pervec bilancit te deges, jane te detyruara te dorezojne edhe Bilancin e Shoqerise MEME.</p> <p>Ju lutem, me konfirmoni, nese kerkohet ne menyre specifike edhe dokument/a te tjera pervec Bilancit te Shoqerise MEME E njjeta pyetje edhe per</p>	<p><b>07.06.2016</b></p> <p>Përsëndetje,</p> <p>Referuar pyetjes tuaj, ju sqarojmë si më poshtë vijon</p> <p>Neni 43, i Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, parashikon se subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë, ndër të tjera, pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme.</p> <p>Bazuar në sa më sipër, detyrimi për depozitimin e pasqyrave financiare bie mbi subjektin e regjistruar në regjistrin tregtar. Nuk parashikohet detyrimi për depozitimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së huaj.</p> <p>Për sa i përket shoqërive të thjeshta, sqarojmë se detyrimin për depozitimin e pasqyrave financiare e kanë subjektet me një xhiro vjetore mbi 8 milionë lekë. Detyrimi për depozitimin e pasqyrave financiare nuk lidhet me formë juridike të</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		SHOQERITE E THJESHTA.	shoqërisë.  Faleminderit!		
07.06.2016	Ju lutem nese me ndihmoni me ndonje model per hapje te niptit sekondar. Shoqeria aktuale ndodhet ne qytetin e Durresit dhe duam te hapim nje zyre tjeter ne Tirane me te njejtin Nipt. Shpresoj te me ketheni prgj sa me shpejte te jete e mundur. Ju faleminderit!	<b>07.06.2016</b>  Përshëndetje,  Hartimi i dokumentacioni shoqërues për aplikim, në rastin konkret kërkesa e administratorit për hapjen e adresës dytësore, ndër të tjera duhet të përmbajë elementët e parashikuar në nenin 11 të ligjit 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, konkretisht: a) numrin unik të identifikimit (NUIS/NIPT); b) formën ligjore të shoqërisë; c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj; Gjithashtu, në kërkesë duhet të specifikohet saktë adresa dytësore që kërkohet të hapet. Kërkesa duhet të nënshkruhet nga administratori i shoqërisë.			
18.05.2016	Po perpiqemi te dergojme bilancin ne faqen e-Albania,por del server error in application.do zgjase shume kjo situata se duhet ta dergojme keto dite bilancin.	<b>16.06.2016</b>  Pershendetje,  Referuar pyetjes tuaj, sqarojme:  Portali unik qeveritar e-albania.al administrohet dhe zhvillohet nga Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit  Cdo veprim qe lidhet me portalin e-albania kryhet nga administratoret e portalit e-albania.  Per cdo paqartesi vizitoni faqen zyrtare <a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania .al</a> .			

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

	18.05.2016	<p>Ju lutem nese mund te me sqaroni:</p> <p>1.Kerkoj qe te regjistrohem ne faqen e-Albania, por pas plotesimit te formularit te regjistrimit ne postin "Ju lutem vendosni kodin e regjistrimit qe ju ka ardhur ne SMS : " nuk me vjen SMS ne celularin qe une kam deklaruar.</p> <p>2.Per te bere pagesen e gjobes per mos depozitimin e bilacit 2014, mund te behet pagesa ne banke pa marre fature pagese nga ju?</p>	<p><b>16.06.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Referuar pyetjes se pare, lutem verifikoni numrin qe keni depozituar per ardhjen e mesazheve nga portali e-albania.</p> <p>Persa i perket pyetjes se dyte, lidhur me pagesen e gjobes per depozitimin e bilancit, lutem shkarkoni mandatin e fatures ne linkun <a href="https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4514">https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4514</a> dhe pastaj kryeni pagesen ne bank.</p> <p>Faleminderit</p>		
	11.05.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Duam te kamojme online bilancin e Shoqerise Klid Ekspres me NIPT: K22301004Q per periudhen 2014, por ne momentin qe klikoj ne opsionin Perdor tek sherbimi i Kalimit te Bilancit vjetor me del faqa me linkun e meposhtem,</p> <p><a href="https://v1.ealbania.al/layouts/Authenticate.aspx?Source=%252FFormServerTemplates%252FBilanci.xsn">https://v1.ealbania.al/layouts/Authenticate.aspx?Source=%252FFormServerTemplates%252FBilanci.xsn</a></p> <p>Ju lutem na jepni nje zgjidhje se si te veprojmë pasi duhet patjetër</p>	<p><b>16.06.2016</b></p> <p>Përsëhendetje,</p> <p>Referuar pyetjes tuaj, sqarojmë:</p> <p>Një nga shërbimet që ofrohet nëpërmjet portalit e-albania (<a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a>), është edhe depozitimi i bilancit dhe i raporteve të auditimit. Fillimisht hyni në portalin <a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a>, klikoni butonin "Hyr". Më pas duhet të vendosni të dhënat e sakta: Username (numri personal i kartës së identitetit) dhe Password (fjalëkalimi), të cilin e keni vendosur gjatë fazës së regjistrimit. Për të vazhduar më tej shtypni butonin "Identifikohu".</p> <p>Pasi të keni plotësuar të gjitha fushat e kërkuara, përzgjidhni shërbimin që do të regjistroni, konkretisht shërbimin "<b>Depozitimi i bilancit vjetor në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit</b>", dhe ne fund do tju shfaqet formulari i aplikimit për depozitimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit.</p>		



## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		ta mbyllim kete procedure, Jemi ne pritje te pergjigjes tuaj, Ju faleminderit,	Lutem, për çdo paqartesi klikoni ne linkun: <a href="https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4514#">https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4514#</a> .  Faleminderit,		
	09.06.2016	Pershendetje Gjate depozitimit te Bilancit per vitin 2014 ne portalin e-ALBANIA kemi vendosur passwordin gabim per depozitimin e bilancit per vitin 2014 dhe nuk mund te bejme depozitimin e bilancit per kete vite  SHOQERIA ALB-STAR (NIPTI J62903512W)  Ne kerkojme nga ana juaj te na ndihmoni duke na dhene passwordin per te zgjidhur kete problem Ju lutem merni ne konsiderate shqetsimin tone JU faleminderit	<b>16.06.2016</b>  Pershendetje,  Referuar kerkeses tuaj, sqarojme si me poshte:  Ndryshimi i passwordit behet ne portalin e-albania. Per te bere ndryshimin, gjeni bashkelidhur manualin.  Per cdo informacion lidhur me portalin e-albania, lutem klikoni ne linkun: <a href="https://e-albania.al/">https://e-albania.al/</a>  Faleminderit,		
	09.06.2016	Te nderuar znj/z. te Qendres Kombetare te Biznesit. Pershendetje.  Ka 2 dite qe platforma per dorzimin e bilanceve ne menyre elektronike nuk punon.  Ju lutemi shikojeni. Ju faleminderit	<b>16.06.2016</b>  Portali unik qeveritar e-albania.al administrohet dhe zhvillohet nga Agjencia Kombetare e Shoqërise se Informacionit  Cdo veprim qe lidhet me portalin e-albania kryhet nga administratoret e portalit e-albania.  Per cdo paqartesi vizitoni faqen zyrtare <a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a> .		
	14.06.2016	Pershendetje , kam perfunduar fakultetin e gjuheve te huaja dega rusisht dhe perfunduar kursin e	<b>16.06.2016</b>  Përsëndetje,		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>kujdestarise te femijes prane DRPP 1 .Dua te di kam te drejte licensimi per kopesht ? faleminderit</p>	<p>Në përgjigje të email-it tuaj dëshirojmë t'ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Në shtojcën e Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë parashikuar lejet dhe licencat që lëshohen në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, në Aneksin 1 dhe 2, të VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, dalë në zbatim të Ligjit Nr. 10081, janë të përcaktuara licencat dhe lejet që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe ato që trajtohen pa përfshirjen e QKB-së. Ndër licencat e parashikuara në Aneksin 1, të VKM Nr. 538, është edhe licenca, “<i>Arsimi parashkollor (kopësht)</i>” me kodin IX.1.A.1. Kjo licencë është konceptuar si licencë e grupit 3, dhe trajtohet nëpërmjet QKB.</p> <p>Subjektet të cilat në objektin e veprimtarisë së tyre kanë ushtrimin e aktivitetit të lartpërmendur, kanë detyrimin t’i nënshtrohen licencimit përkatës.</p> <p>Në përfundim, bazuar në sa ju parashtroni në email, mbi natyrën dhe llojin e aktivitetit që kërkonte të ushtroni, duke u mbështetur në argumentimin e mësipërm dhe legjislacionin në fuqi arrijmë në konkluzionin se për ushtrimin e aktivitetit</p>		
--	--	---	--	--	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>“kopësht”, ju keni detyrimin për t’u pajisur me licencën “Arsimi parashkollor ( kopësht)” me kodin IX.1.A.1, aplikimi për të cilën bëhet pranë sporteve të QKB.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni tabelën përkatëse mbi dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me licencën e lartpërmendur.</p> <p>Për çdo paqartësi tjetër ju mund të drejtoheni pranë spoteleve të QKB.</p>		
	13.06.2016	<p>Pershendetje, Nje pyetje: Nese duhet te paraqes nje aplikim per licence per shkolle per llogari te nje shoqerie, duhet te kem autorizim normalisht nga administratori i firmes: Ky autorizim mjafton i thjeshte, me firme dhe vule, apo duhet me deomos i bere te noteri?</p>	<p><b>20.06.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Lidhur me pyetjen tuaj ju sqarojme se, ne baze te legjislacionit ne fuqi, per te kryer aplikimin per licence prane QKB-se, ne rastin e shoqerive tregtare, mjafton nje autorizim i thjeshte me firmen dhe vulen e shoqerise, pa qene e nevojshme te noterizoni dokumentin e perfaqesimit.</p>		
	18.06.2016	<p>Pershendetje, jam regjistruar si Person Fizik dhe do te kryej aktivitet cerdhe e kopesht.</p> <p>Ju lutem me konfirmoni nese duhet te aplikoj prane institucionit tuaj per tu paisur me leje per licensim nga ju( me pare Qendra Kombetare e Licensimit)</p> <p>Nese duhet te aplikojme per licensim, ju lutemi na dergoni dhe formularin e dokumentave qe duhet te paraqesim. Pune te mbare</p>	<p><b>20.06.2016</b></p> <p>Përshëndetje,</p> <p>Në përgjigje të email-it tuaj dëshirojmë t’ju informojmë si më poshtë vijon.</p> <p>Në shtojcën e Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë parashikuar lejet dhe licencat që lëshohen në Republikën e</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>Shqipërisë. Gjithashtu, në Aneksin 1 dhe 2, të VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, dalë në zbatim të Ligjit Nr. 10081, janë të përcaktuara licencat dhe lejet që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe ato që trajtohen pa përfshirjen e QKB-së. Ndër licencat e parashikuara në Aneksin 1, të VKM Nr. 538, është edhe licenca, “<i>Arsimi parashkollor (kopësht)</i>” me kodin IX.1.A.1. Kjo licencë është konceptuar si licencë e grupit 3, dhe trajtohet nëpërmjet QKB.</p> <p>Subjektet të cilat në objektin e veprimtarisë së tyre kanë ushtrimin e aktivitetit të lartëpërmendur, kanë detyrimin t’i nënshtrohen licencimit përkatës.</p> <p>Në përfundim, bazuar në sa ju parashtroni në email, mbi natyrën dhe llojin e aktivitetit që kërkonit të ushtroni, duke u mbështetur në argumentimin e mësipërm dhe legjislacionin në fuqi arrijmë në konkluzionin se për ushtrimin e aktivitetit “kopësht”, ju keni detyrimin për t’u pajisur me licencën “<i>Arsimi parashkollor (kopësht)</i>” me kodin IX.1.A.1, aplikimi për të cilën bëhet pranë</p>		
--	--	--	--	--	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>sporteleve të QKB.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni tabelën përkatëse mbi dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me licencën e lartpërmendur.</p>		
16.06.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Ju shkruajme nga Giodiche Chair Complements Shpk, shoqeri ne likujdim.</p> <p>Me date 18.05.2016 ne kemi dorezuar njoftimin e dyte drejtuar kreditoreve dhe tani po merremi me pergatitjen e bilancit te mbylljes.</p> <p>Ceshtja qe me shqeteson paksa dhe qe nuk e kam mjaftueshem te qarte eshte raporti i likuidatorit.</p> <p>Ju lutem a mund te me ndihmoni, cfare perfshin ky raport? DO e vleresonim ndihmen tuaj, Ju falenderojme</p>	<p><b>20.06.2016</b></p> <p>Përsëndetje,</p> <p>Referuar pyetjes tuaj, ju sqarojmë se:</p> <p>Bazuar në nenin 43, pika 3, gërma “ç” e ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, subjektet e regjistruara kanë detyrimin, ndër të tjera, të regjistrojnë dhe të depozitojnë në regjistrin tregtar aktet e hapjes së procedurave të likuidimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.</p> <p>Procedura, afatet dhe aktet e hapjes së procedurave të likuidimit, si dhe aktet e ndërmjetme, parashikohen në nenin 104, 190 deri 203 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.</p> <p>Në nenin 200, të këtij ligji, me titull “Raporti i likuiduesit, shpërblimi dhe shkarkimi”, parashikohet se: <i>“1. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërblimit të likuiduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, aktivet e mbetura u shpërndahen ortakëve ose aksionarëve.2. Pas shlyerjes së</i></p>			

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p><i>detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, likuiduesit u paraqesin ortakëve të tjerë të shoqërisë kolektive e komandite apo asamblesë së përgjithshme një raport për procedurën e likuidimit, për detyrimet e shlyera dhe për shpërblimin e tij. 3. Nëse ortakët e tjerë në shoqërinë kolektive e komandite apo asambleja e përgjithshme miratojnë raportin, likuiduesit lirohen nga detyra dhe përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport. 4. Nëse raporti nuk miratohet, likuiduesit mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për ta shkarkuar nga detyra, si pasojë e përmbushjes në mënyrën e duhur të detyrave. 5. Pas shkarkimit të likuiduesit nga gjykata, ai ka të drejtë të përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport.”.</i></p> <p>Bazuar në sa më sipër, raporti për procedurën e likuidimit, është akti të cilin likuiduesi mban pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, ku evidenton, procedurën e ndjekur, shlyerjen e detyrimeve, si dhe shpërblimin e tij, etj. Ky akt i paraqitet për miratim asamblesë së ortakëve.</p>		
	16.06.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Ju lutem, duam te dime a kane detyrim bizneset e vogla (me TVSH) per depozitim bilanci prane QKB ne afatin e publikuar prej jush 31 korrik? Do jemi ne pritje te nje pergjigjeje!</p> <p>Faleminderit!</p>	<p><b>20.06.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Referuar pyetjes tuaj, ju sqarojmë se: Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, neni 43, pika 3 (a), subjektet kanë detyrimin të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme. Detyrimin për depozitimin e dokumenteve të sipërcituara e kanë subjektet që janë regjistruar <b>me përgjegjësinë tatimore tatim fitimi.</b></p>		
	20.06.2016	Pershendetje	<b>21.06.2016</b>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>Do te doja nje informacion.</p> <p>Nje subjekt i cili ka kaluar si subjekt i madh me tatim fitim ne gjysmen e dytre te vitit 2015 i cili ka bere 2 bilance per 2015. pasqyra financiare per gjashtmujorshin e pare si biznes i vogel dhe pasqyra financiare per gjasht mujorshin tjetet si biznes i madhe.</p> <p>Ne QKB duhet te dorezojme nje permbledhje te dy bilanceve apo vetem bilancin per pjesen qe ka gene biznes i madh</p> <p>Jemi ne pritje te pergjigjes tuaj.</p>	<p>Përsëhendetje,</p> <p>Referuar pyetjes tuaj, ju sqarojmë se:</p> <p>Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, neni 43, pika 3 (a), subjektet kanë detyrimin të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme. Detyrimin për depozitimin e dokumenteve të sipërcituara e kanë subjektet që janë regjistruar me përgjegjësinë tatimore tatim fitimi.</p> <p>Bazuar në sa më sipër, duhet të depozitoni pasqyrat finaciare vjetore, të mbajtuara nga subjektit juaj në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Megjithëse, për shkak të ndryshimit të përgjegjësisë tatimore, pasqyrat finaciare janë mbajtur në dy akte më vete (gjashtëmujore), këto dokumente duhet t'i depozitoni në regjistrin tregtar në një aplikim të vetëm.</p>		
15.06.2016	<p>Pershendetje</p> <p>Jam ALMA, administratore e L11408028G Me eshte refuzuar disa here aplikimi per dorezimin e bilancit vetem per mungese se FORMES SE APLIKIMIT</p> <p>JU lutem me udhezoni si behet uplodimi i kesaj forme, ?</p> <p>Ne pritje, Faleminderit</p>	<p><b>21.06.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Referuar problemit tuaj, mbi arsyen e refuzimit gjate depozitimit te bilancit, ne momentin kur aplikimi kerkon neshkrim elektronik ju duhet te anuloni proceduren per neshkrim dhe ne kete moment formulari I aplikimit do te vi ne QKB per shqyrtim.</p> <p>Bashkelidhur gjeni manualin per anulimin e procedures se neshkrimit elektronik.</p> <p>Lutem per cdo paqartesi referojuni faqes tone zyrtare <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a> .</p>			

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			Faleminderit,		
	17.06.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Kam hapur nje nipt ne ermin tim, por ne shtator te vitit 2015 eshte bere shitja 100% e aksioneve.</p> <p>Aksioneri i ri ska bere ndryshimet e nevojshme ne QKR, pasi ka ikur jashte Shqiperise pas shitjes.</p> <p>Problemi qendron se une disponoj vetem kontraten noteriale te shitjes, si mund te veproj qe te behet ndryshimi?</p>	<p><b>20.06.2016</b></p> <p>Përsëndetje,</p> <p>Referuar pyetjes tuaj, ju sqarojmë se:</p> <p>Nenin 26, pika 3 e Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, përcakton se: “Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet, mund të kryhen, gjithashtu, dhe nga anëtari, ortaku apo aksioneri, të cilit këto i përkasin.”.</p> <p>Bazuar në dispozitën e sipërcituar, aplikimi për regjistrimin e kontratës së shitblerjes së kuotave, mund të bëhet nga përfaqësuesi i shoqërisë (administratori) ose çdo person i autorizuar prej tij. Gjithashtu, aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike( në këtë rast kontrata e shitblerjes së kuotave), që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet, mund të kryhen, gjithashtu, dhe nga anëtari, ortaku apo aksioneri, të cilit këto i përkasin.”.</p>	VAZHDON	



## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

	21.06.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>duke ju falenderuar per pergjigjen tuaj, kerkoj dhe nje sqarim te fundit.</p> <p>Une me shitjen e 100% te aksioneve, kam hequr dore dhe administrimi; pra nuk kam asnje te drejte me ne ate kompani.</p> <p>Kerkoj nje menyre per te bere ndryshimet, pasi personi qe ia kam shitur nuk eshte interesuar per ti bere ato ( figuroj akoma si administratore dhe ortake 100%).</p>	<p><b>22.06.2016</b></p> <p>Përshëndetje,</p> <p>Pas verifikimit të kryer rezulton se, aktualisht administrator subjektit “Akro Structure” sh.p.k., është zj. Blerta Çuko.</p> <p>Sqarojmë se, ndryshimi i administratorit të shoqërisë, sipas parashikimeve të nenit 81 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve.</p> <p>Faleminderit</p>	PERFUNDUAR	
	21.06.2016	<p>Pershendetje ,</p> <p>Te nderuar Znj/Zoterinj,</p> <p>Duke ju falenderuar per mirekuptimin , ju lutem na ndihmoni me nje informacion te detajuar lidhur me proceduren e dorezimit te bilancit.</p> <p>Ka ndryshim ne procedure ose nje specifike qe ka ndryshuar.</p> <p>Mbetemi Ne pritje te pergjigjes Tuaj.</p>	<p><b>22.06.2016</b></p> <p>Përshëndetje,</p> <p>Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, neni 43, pika 3 (a), subjektet kanë detyrimin të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme.</p> <p>Detyrimin për depozitimin e dokumentave të sipërcituara e kanë subjektet që janë regjistruar me përgjegjësinë tatimore tatim fitimi, të cilët duhet të depozitojnë pranë QKB-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pasqyrat financiare vjetore të skanuara në format PDF.</li> <li>- Raportin e auditimit dhe ecurisë së veprimtarisë (kur mbajtja e tyre është e detyrueshme);</li> <li>- Vendimin për miratimin e pasqyrave financiare (sipas kërkesës ligjore).</li> </ul>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>Afati i fundit i dorëzimit është data 31 Korrik 2016.</p> <p>Mënyra e depozitimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Depozitimi i dokumentave të sipërcituara mundësohet vetëm nëpërmjet aplikimit online në portalin qeveritar e-albania , duke ndjekur të gjitha hallkat e procedurës për kryerjen e aplikimit.</li> <li>2. Formati elektronik i ruajtjes së pasqyrave financiare, duhet të jetë në PDF.</li> <li>3. Individit, i cili do të kryejë aplikimin, duhet të jetë i pajisur me kartë identiteti ose pasaportë biometrike.</li> <li>4. Shërbimi ofrohet pa pagesë.</li> </ol> <p><b>BËJNË PËRJASHTIM SUBJEKTET ME ADMINISTRATOR TË HUAJ DHE SHOQËRITË E KURSIT KREDITIT, APLIKIMET E TË CILEVE DO TË VIJOJNË TË KRYHEN VETËM NË SPORTELET E SHËRBIMIT TË QKB-së.</b></p> <p>Për më shumë informacion vizitoni: <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a>, <a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a></p>		
	24.06.2016	<p>Pershendetje!</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kerkoje informacion lidhur me dokumentacionin qe duhet te paraqes Bashkia per pajisjen me Licence te tipit III.2.B.</li> </ol> <p>Ju informoj se nga ana e Bashkise Roskovec nuk eshte lidhur nje marreveshje me kontraktore per mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane. Kjo procedure realizohet nga</p>	<p><b>24.06.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Në përgjigje të email-it tuaj dëshirojmë t'ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Në shtojcën e Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë parashikuar lejet dhe licencat që lëshohen në Republikën e</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>Sektori i pastrimit, Drejtoria e Sherbimeve me automjetet/kamion qe disponojme. A eshte e nevojshme pajisja me Licence III.2.B ne kete rast?</p> <p>Presim nje pergjigje nga ana juaj</p>	<p>Shqipërisë. Gjithashtu, në Aneksin 1 dhe 2, të VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, dalë në zbatim të Ligjit Nr. 10081, janë të përcaktuara licencat dhe lejet që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe ato që trajtohen pa përfshirjen e QKB-së. Ndër licencat e parashikuara në Aneksin 1, të VKM Nr. 538, është edhe licenca “<i>veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis</i>”, me kodin III.2.B.</p> <p>Kjo licencë është konceptuar si licencë e grupit 3 dhe trajtohet nëpërmjet QKB-së, që do të thotë se miratimin ose refuzimin përfundimtarë të kërkesës e vendos institucioni tjetër kompetent. Gjithashtu, në pikën 9, të Kreut II, të Kategorisë III.2, të Fushës III, të VKM Nr.538, përcaktohet se <i>veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.</i></p> <p>Për sa më sipër sqarojmë se aplikimi për pajisjen me licencën “<i>veprimtaritë e tjera profesionale</i></p>		
--	--	--	--	--	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p><i>lidhur me ndikimin në mjedis</i>”, me kodin III.2.B, kryhet pranë sporteleve të QKB, aplikim i cili i nënshtrohet një kontrolli paraprak mbi plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm nga regjistruarit e QKB dhe më pas i përcillet elektronikisht institucionit tjetër përgjegjës (strukturave të Ministrisë së Mjedisit sipas kompetencës territoriale) për vendimmarrje përfundimtare mbi miratimin ose refuzimin e kërkesës.</p> <p>Në përfundim, bazuar në sa ju parashtroni në email, mbi natyrën dhe llojin e aktivitetit, duke u mbështetur në argumentimin e mësipërm dhe legjislacionin në fuqi arrijmë në konkluzionin se për ushtrimin e aktivitetit të <i>grumbullimit, transportimit të mbetjeve urbane</i>, është detyrim pajisja me licencën “<i>veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis</i>”, me kodin III.2.B, duke përmbushur kështu detyrimet ligjore për ushtrimin e këtij aktiviteti.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni tabelën përkatëse mbi dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me licencën e lartpërmendur.</p> <p>Për çdo paqartësi tjetër ju mund të paraqiteni pranë sporteleve të QKB.</p>		
--	--	---	--	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

	14.06.2016	<p>Me dt.10.06.2016 është paraqitur ceshtja CN-747384-06-16.</p> <p>Njoftimi mbas aplikimit nga ana Juaj është "Ceshtja jo e plote".</p> <p>Lutem na bene me dijeni cfare informacioni shtese duhet qe te ceshtja te behet e plote.</p>	<p><b>29.06.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Lidhur me aplikimin me numër çeshtje CN-747384-06-16, sqarojme se, Vendimi nr.59, date 10.06.2016, paraqitur si dokument shoqerues duhet saktësuar si vijon:</p> <p>Se pari: Adresa "AA 193 HR nuk ekziston e hapur ne sistem, e per pasoje nuk mund te aplikojte shoqeria per mbyllje.</p> <p>Se dyti: Ne sistem, figuron e hapur adresa: Autobus Otoyol me targe AA314GT dhe jo adresa dytesore: AA 314 GT autobus Iveco, sic eshte cituar ne vendimin e sipercituar.</p> <p>Faleminderit</p>		
	14.06.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Praktika e aplikimit per regjistrimin e nje SH.P.K-je me numer CN-749256-06-16 rezulton e paplote, ju lutem na sqaroni ku qendron gabimi ne ndarjen e kuotave.</p> <p>Kapitali themeltar eshte 100 leke me dy ortake, me kontribut 50 leke secili, ne perqindje 50 me 50 dhe me ndarje kuotash 5 me 5</p> <p>Bashkengjitur kopje e aplikimit dhe kopje e neneve perkatese</p> <p>Ne pritje te pergjigjes tuaj</p>	<p><b>29.06.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Ne pergjigje te e-mail tuaj ju bejme me dije se, aplikimi me numer ceshtje CN-749256-06-16 , eshte miratuar. Verifikimin mund ta kryeni ne link <a href="http://www.qkb.gov.al">http://www.qkb.gov.al</a> .</p> <p>Faleminderit</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

	27.06.2016	<p>Pershenditje          Administratori i shoqerise AFIMM me NIPT J92114005U ka derguar dy here bilancin e vitit 2015 dhe ende pas mbi 15 ditesh nuk i eshte shtuar tek extrati historik          Bashkelidhur keni edhe mesazhin pas aplikimit online.          Lutemi na sqaroni si te veprojmë</p>	<p><b>29.06.2016</b>          Pershendetje,          Ne pergjigje te e-mail tuaj ju bejme me dije se, pas verifikimit rezulton se aplikimi i kryer ne daten 6/11/2016 oren: 10:24 AM eshte refuzuar me arsyen (te cilin e gjeni bashkangjitur), e njejta gje vlen dhe per aplikimin e dyte.          Per te verifikuar statusin e aplikimit lutem klikoni ne linkun e meposhtem:  <a href="http://www.qkb.gov.al/nrc/Businesses_in_Passive_Status.aspx">http://www.qkb.gov.al/nrc/Businesses_in_Passive_Status.aspx</a></p>		
	29.06.2016	<p>Pershendetje,          Deshiroj te rezervoj emrin e meposhtem          ROYAL TRADE SHA          Faleminderit</p>	<p><b>29.06.2016</b>          Përsëndetje,          Nga verifikimet e kryera rezulton se, emri ROYAL TRADE SHA është i ngjashëm me emrin e një subjekti tjetër të regjistruar në Regjistrin Tregtar “Royal Trading”, në bazë të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007." Për Qendrën Kombëtare të Binzesit ", në nenin 23 pika 1, ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar i subjekteve me emra të njëjtë ose të ngjashëm.</p>		
	28.06.2016	<p>Jemi subjekti Euro-Paper sha. tirane          Vitin e kaluar kemi depozituar bilancin ne QKR ,por nuk kemi mbajtur shenim fjalekalimin dhe pasuordin dhe te dhenat e tjera ,bilancin 2015 nuk e depozitojme dot pa keto te dhena ,ju lutem na i konntaktoni keto te dhena ne kete anderse email.</p>	<p><b>30.06.2016</b>          Pershendetje,          Referuar kerkeses tuaj, sqarojme si me poshte:          Ndryshimi i passwordit behet ne portalin e-albania. Per te bere ndryshimin, gjeni bashkelidhur manualin.          Per cdo informacion lidhur me portalin e-albania, lutem klikoni ne linkun: <a href="https://e-albania.al/">https://e-albania.al/</a></p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		faleminderit per bashkepunimin.	Faleminderit		
29.06.2016	pershendetje! jame nje studio kontabile dhe  po pregatitemi per dorezuar pa sqyrat financiare e dokumenta te tjera sipas detyrimit ligjor qe kemi ne lloje dhe formen e tyre brenda dates 31.03.2016.  jeni te lutur na sqaroni se kush e ka detyrimin ligjor per te dorez uar keto pasqyra. subjektet mbi 8miljon lek xhir o opo te gjitha subjektet e ngarkuar me pergjegjesi tatimo re per tatim fitimin, pasi sic paraqitet ne kerkesat tuaja kjo e dyta eshte shume e ndryshme nga e paar. ju lutem komentini tuaj zyrtar per kete qellim.	<b>11.07.2016</b>  Përsëhendetje,  Lidhur me pyetjen Tuaj, ju bëjmë më dije si më poshtë:  Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, neni 43, pika 3 (a), subjektet kanë detyrimin të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme. Detyrimin për depozitimin e dokumentave të sipërcituara e kanë subjektet që janë regjistruar me përgjegjësinë tatimore tatim fitimi, të cilët duhet të depozitojnë pranë QKB-së: - Pasqyrat financiare vjetore të skanuara në format PDF. - Raportin e auditimit dhe ecurisë së veprimtarisë (kur mbajtja e tyre është e detyrueshme); - Vendimin për miratimin e pasqyrave financiare (sipas kërkesës ligjore).  Për të verifikuar detyrimin për depozitimin e pasqyrave financiare, raporteve të auditit dhe veprimtarisë, <b>klikoni këtu.</b>			

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			Afati i fundit i dorëzimit është data 31 Korrik 2016.		
	28.06.2016	<p>Pershendetje</p> <p>ju lutem duam nje sqarim te hollesishem lidhur me dorzimin e bilancit</p> <p>per subjektet qe nuk kan patur veprimtari per 2015 jane te detyruar te dorzojne bilanci?</p>	<p><b>11.07.2016</b></p> <p>Përsëhendetje,</p> <p>Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, neni 43, pika 3 (a), subjektet kanë detyrimin të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme.</p> <p>Detyrimin për depozitimin e dokumentave të sipërcituara e kanë subjektet që janë regjistruar me përgjegjësinë tatimore tatim fitimi, të cilët duhet të depozitojnë pranë QKB-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pasqyrat financiare vjetore të skanuara në format PDF.</li> <li>- Raportin e auditimit dhe ecurisë së veprimtarisë (kur mbajtja e tyre është e detyrueshme);</li> <li>- Vendimin për miratimin e pasqyrave financiare (sipas kërkesës ligjore).</li> </ul> <p>Për të verifikuar detyrimin tuaj për depozitimin e pasqyrave financiare, raporteve të auditit dhe veprimtarisë, klikoni këtu.</p>		



## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>Afati i fundit i dorëzimit është data 31 Korrik 2016.</p> <p>Për më shumë informacion vizitoni:  <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a>, <a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a> Faleminderit</p>		
	22.06.2016	<p>Do doja te me informonit per dicka</p> <p>Nese i referohemi ligjit perkates kemi dy menyra per likuidimin e ortakut:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. likuidim normal</li> <li>2. likuidim te thjeshtuar (kur ortakët deklarjone se nuk kane borxhe)</li> </ol> <p>Tani kjo deklarate e ortakeve e cila behet per hapjen e likuidimit te thjeshtuar duhet depozituar prane jush, apo nuk eshte e nevojshme?!</p> <p>Duke ju falenderuar paraprakisht, mbetem ne pritje te pergjigjes tuaj.</p>	<p><b>11.07.2016</b></p> <p>Lidhur me pyetjen Tuaj, ju sqarojmë se, sipas parashikimeve të nenit 204 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, shoqëria tregtare mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.</p> <p>Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.</p> <p>Sa më sipër, me qëllim informimin e të tretëve me nisjen e procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar nëpërmjet gjykatës, subjekti duhet të regjistrojë pranë QKB-së, vendimin e shoqërisë/ deklaratën e ortakëve për nisjen e procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar dhe më pas duhet të depozitojë vendimin e gjykatës, me qëllim çregjistrimin e subjektit nga regjistri tregtar.</p>		
	06.06.2016	<p>Pershendetje;Ne perpjekje per te te depozituar Bilancin vjetor 2015 kemi harruar fjalekalimin ,ju lutemi te na ndihmoni</p>	<p><b>11.07.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Referuar kerkeses tuaj, sqarojme si me poshte:</p> <p>Ndryshimi i passwordit behet ne portalin e-albania. Per te bere ndryshimin, gjeni bashkelidhur manualin.</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			<p>Gjithashtu, lutem provojeni perseri kryerjen e veprimit qe doni te realizoni , pasi nga verifikimi ne regjistrin tregtar, te gjitha te dhenat e subjektit: Marika Miha, jane ne rregull.</p> <p>Per cdo informacion lidhur me portalin e-albania, lutem klikoni ne linkun: <a href="https://e-albania.al/">https://e-albania.al/</a></p> <p>Faleminderit,</p>		
30.06.2016	Per subjektin Resmie Banush me NUIS K33714635A nuk me ç'faqet paswordi per dorzimin e bilancit 2015.Regjistrimi i ri nuk me pranohet pasi me thuhet qe subjekti eshte i regjistrua. Si mund te veproje?	<p>11.07.2016</p> <p>Pershendetje,</p> <p>Referuar kerkeses tuaj, sqarojme si me poshte:</p> <p>Ndryshimi i passwordit behet ne portalin e-albania. Per te bere ndryshimin, gjeni bashkelidhur manualin.</p> <p>Per cdo informacion lidhur me portalin e-albania, lutem klikoni ne linkun: <a href="https://e-albania.al/">https://e-albania.al/</a></p>			
06.07.2016	<p>Pershendetje</p> <p>Pyetja ime eshte : Ne lidhje me satusin e biznesit te meposhtem ku mund te terhiqet kartoni i kesaj licence te aprovuar Tipi C?</p> <p>LC-2221-05-2016                      17-05-2016                      Aproveuar                      Aktive</p> <p>PN-3045-06-2016                      Edmond</p> <p>Mato                      K31604229N</p> <p>Falemindetit dhe pune te mbare</p>	<p>11.07.2016</p> <p>Pershendetje,</p> <p>Ne pergjigje te e-mail tuaj ju bejme me dije se, Ju mund ta terhiqni Lejen Mjedisore prane sporteleve tona ne zyrat qendrore, ne adresen: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr.33. Tirane ose ne sportelet tona ne rrethe.</p> <p>Faleminderit</p>			
10.07.2016	<p>Pershendetje.</p> <p>Jam drejtori i Ujesjellesit Fshat Korce Sh.a.</p>	<p>11.07.2016</p> <p>Pershendetje,</p> <p>Referuar kerkeses tuaj, sqarojme si me poshte:</p>			

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>Kemi humbur passwordin dhe nuk mund të logohemi në sistemin e-albania për të bërë deklarinë e Bilancit dhe të Pasqyrave Financiare të vitit 2015.</p> <p>Ju lutem të na jepni mundësinë e një passwordi të ri për të hyrë në sistemin e-albania.</p>	<p>Ndryshimi i passwordit bëhet në portalin e-albania. Për të bërë ndryshimin, gjeni bashkëlidhur manualin.</p> <p>Për çdo informacion lidhur me portalin e-albania, lutem klikoni në linkun: <a href="https://e-albania.al/">https://e-albania.al/</a></p>		
07.07.2016	<p>Pershendetje!</p> <p>Për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) hapje e Nipt sekondar duhet të shoqërohet në QKR me vendim asambleje?! Apo me kërkesë të administratorit?!</p> <p>Ju faliminderit,</p>	<p><b>11.07.2016</b></p> <p>Përsëndetje,</p> <p>Lidhur me kërkesën tuaj, sqarojmë se:</p> <p>Për hapje adrese dytësore, duhen të paraqiten dokumentet si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kërkesë nga administratori për hapjen e adresës dytësore (ku të specifikohet adresa që do të hapet);</li> <li>2. Autorizimi nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi i shoqërisë (administratori);</li> <li>3. Dokument identifikimi të aplikantit;</li> </ol>			
11.07.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Shpresoj në një përgjigje tuajen. Jam studente e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës.</p> <p>Doja të dija nëse mund të siguroj nga ju informacion rreth numrit të subjekteve të regjistruar si persona fizike të vetëpunësuar në profesionet e lira. Kjo do të më ndihmonte në punimin</p>	<p><b>11.07.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Ju bëjmë me dije se, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.9723/ 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.</p>			

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>tim te diplomes. Ju falenderoj paraprakisht</p>	<p>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKR, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.</p> <p>Për përfitimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKR-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).</p> <p>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKR, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.</p>		
04.07.2016	<p>Pershendetje, Ju lutem jam e interesuar te di listen e dokumentave qe duhet te dorezohen ne sportelet tuaja kur nje subjekt farmaceutik ndryshon drejtuesin teknik dhe si rrjedhim licensen ne qendren tuaj.</p> <p>Ju faleminderit.</p>	<p>12.07.2016 Pershendetje! Në përgjigje të e-mail tuaj ju lutem gjeni më poshtë listën e dokumentacionit që duhet të paraqitet për ndryshim të drejtuesit teknik:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Certifikatë për drejtuesin teknik (lëshuar nga Urdhri i Farmacistit)</li> <li>2.Kontratë pune me drejtuesin teknik</li> <li>3.Vetëdeklarim i Drejtuesit Teknik që do angazhohet dhe është i ndërgjegjshëm se do ta ushtrojë këtë rol vetëm për një farmaci</li> </ol> <p>Baza Ligjore: Ligjit Nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” VKM Nr. 144, datë 11.02.2009 VKM Nr. 538, datë 26.05.2009</p>			

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

	13.07.2016	<p>Pershendetje !                  Ju lutem me ktheni nje pergjigje se vajti hera e 5 qe me bllokohet llogaria .                  Faleminderit !</p>	<p><b>18.07.2016</b>                  Pershendetje,</p> <p>Lutem ti drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jape te dhenat per akelimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.</p> <p>Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.</p>		
	13.07.2016	<p>Emri i subjektit qe nuk mund te dorezoj bilancin sepse kam haruar pasuordin eshte E&amp;H ALBAFRIGOR</p>	<p><b>18.07.2016</b>                  Pershendetje,</p> <p>Lutem ti drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jape te dhenat per akelimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.</p> <p>Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.</p>		
	13.07.2016	<p>Pershendetje!</p> <p>Per ngarkimin ne portalin e QKR-se te Pasqyrave Financiare 2015 te subjektit me NIPT K37506197N,me nevojitet ndihma juaj pasi nuk disponoj asnje te dhene :(kodi e passwordi i ketij subjekti).                  Ju lutem me ndihmoni me informacion se si te veproje ne kete rast.</p>	<p><b>18.07.2016</b>                  Pershendetje,</p> <p>Lutem ti drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jape te dhenat per akelimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.</p> <p>Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

	14.07.2016	<p>Gjate dorzimit te bilanceve po hasim veshtiresi si :</p> <p>Per subjektin Resmije Banush me nipt K33714635A, megjithese eshte dorzuar bilanc edhe per vitin 2014, biznesi i ketij subjekti nuk rezulton i regjistruar dhe nuk behet regjistrimi fillestar i tij.</p> <p>Per subjektet Pirro Shkurti me nipt K33708619L, Ketu Cici me nipt K33714731U dhe Paqesor Hoxhallari me nipt L14008601M ehste bere regjistrimi si individe me karten e identitetit nuk behet regjistrimi i biznesit te tyre.</p> <p>Per sa me siper ju lutemi qe brenda mundesive te na ndihmoni.</p>	<p><b>18.07.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Lidhur me subjektin Resmije Banush me nipt K33714635A, lutem t'i drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jap te dhenat per aksesimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.</p> <p>Bashkelidhur po ju dergojme manualin per resetimin e passwordit.</p> <p>Gjithashtu ju bejme me dije se, per subjektin Ketu Cici me NIPT K33714731U duhet te paraqiteni prane sporteleve te QKB-se per perditimin e numrit personal (NID) te administratorit te subjektit, pasi mund te kryhet regjistrimi i subjektit ne portal.</p> <p>Ndersa per subjektet Pirro Shkurti me nipt K33708619L dhe Paqesor Hoxhallari me nipt L14008601M lutem te provoni perseri</p> <p>Faleminderit</p>		
--	------------	---	---	--	--

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

	15.07.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Ju lutem te na pajisni me nje pass te ri per subjektin Olger shpk me NIPT K31519047C sepse pass i vjeter rezulton i bllokuar duke mos ne dhene akses ne faqen e subjektit per te realizuar deklarimet perkatese.</p> <p>Ne pritje te nje pergjigje nga ana juaj,</p>	<p><b>18.07.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Lutem t'i drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jap te dhenat per akelimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.</p> <p>Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.</p>		
	16.07.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Po ju kontaktoj ne emer te Izabela Sulaj, subjekti Farmaci me NIPT K92213014S. Une jam personi perfaqesues sipas prokures se posacme (ketu bashkengjitur) te Izabea Sulaj.</p> <p>Problemi konsiston ne pamundesine per t'u loguar ne e-Albania. Kam kerkuar passwordin dhe me kane ardhur disa passworde, por asnjeri nga ata nuk mundeson login. Rezultati deshton ose llogaria bllokohet.</p> <p>ju lutem me ndihmoni qe t'a zgjidhim ne menyre qe te procedoj me dorezimin e bilancit brenda afatit te caktuar.</p> <p>Ju faleminderit,</p>	<p><b>18.07.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Lutem t'i drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jap te dhenat per akelimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.</p> <p>Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.</p> <p>Faleminderit,</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

	14.07.2016	<p>Pershendetje,</p> <p>Per subjektin Zef Macaj me nr Nipt L21808013S nuk perfundojme depozitimin online te Bilancit te vitit 2015 ne faqen e-albania, pasi procesi pas komandes Nenshkruaj dhe Dergo mbetet loading vazhdimisht pa te lejuar te vazhdosh proceduren e metejshme.</p> <p>Nuk na regjistrohet Biznesin B&amp;TS me nr NIPT L41307004B me llogari administratori te Endrit Sino ne faqe e-albania. Na shfaqet loading vazhdimisht. Bashkelidhur aplikimin.</p> <p>Jemi ne pritje te zgjidhjes se situates. Ju faleminderit!</p>	<p>19.07.2016</p> <p>Pershendetje,</p> <p>Ju bej me dije se per subjektin B&amp;TS me nipt L41307004B, ne momentin e regjistrimit si subjekt, kur plotesoni emrin e subjektit vendosni B dhe TS ose B and TS, por mos perdorni shenjen "&amp;".</p> <p>Ndersa per subjektin Zef Macaj me nr Nipt L21808013S provojeni perseri.</p> <p>Faleminderit</p>		
	19.07.2016	<p>Pershendetje</p> <p>Jam Perfaqsesi i Subjektit Muharem Hoxha me NIPT K73005015D dhe per fat te keq kam harruar kodin per te hyr ne e-Albania.</p> <p>Dhe me rubiken keni harruar kodin nuk mund ta gjej pasi nuk di kodin e siguris (best bood etj etj)</p> <p>Ju lutem mund te me ndihmoni si mund ta hap kete portal qe te mund te bej deklarimin e bilancit dhe une.</p> <p>Ju Faleminderit</p>	<p><b>21.07.2016</b></p> <p>Pershendetje,</p> <p>Lutem t'i drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jap te dhenat per akeseimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.</p> <p>Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.</p> <p>Faleminderit,</p>		



## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

21.07.2016	<p>Pershendetje, Kemi bere rregjistrimin ne portalin tuaj te adminstratorit te shoqerise Amadeus Group sh.a me nipt J72118005P z.Besim Elshani. Kerkojme te deklarojme bilacin ne QKR kur futemi te e - sherbimet dhe kerkojme te perdorim opsionin per dergimin e bilancit pa bere akoma ngarkimin e tij na thote me te kuqe NDODH NJE PROBLEM GJATE NGARKIMIT TE TE DHENAVE. Ky fenomen ka 24 ore qe me ndodh. Ju lutem na asistoni pasi duanm te bejme deklarimin ne QKr te bilancit te vitit 2015.</p>	<p><b>21.07.2016</b> Pershendetje,  Lutem t'i drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jap te dhenat per akelimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.  Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.  Faleminderit,</p>		
20.07.2016	<p>Jam administratori i Ashel shpk me seli ne Dober Malesi e madhe ,me nipt L38222701M,kam harruar fjalekalimin e hapur per te depozituar bilancin ne Qkr ,Si mund te veprojt?</p>	<p>21.07.2016 Pershendetje,  Lutem t'i drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jap te dhenat per akelimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.  Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.</p>		
21.07.2016	<p>Pershendetje, ju lutem, me duhet nje password per ne portalin e-albania, per Shoqerine "B&amp;AD CONSTRUCTION", pasi Shoqeria e ka harruar.</p>	<p>22.07.2016 Pershendetje,  Lutem t'i drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin <a href="http://www-e-albania.al">www-e-albania.al</a>, pasi QKB nuk mund t'ju jap te dhenat per akelimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te</p>		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		Faleminderit.	mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.  Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.		
21.07.2016	Pershendetje!	Cfare dokumentash me duhen per te kryer ndryshimin e adreses se selise kryesore te subjektit??  Faleminderit!	22.07.2016  Përshëndetje,  Lidhur me kërkesën tuaj, sqarojmë si më poshtë vijon;  Për ndryshimin e adresës së shoqërisë, duhen të paraqiten dokumentet si me poshte:  1. Vendimi i ortakut ose i asamblesë së ortakëve për ndryshimin e adresës së selisë. 2. Autorizimi nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi i shoqërisë (administratori); 3. Dokument identifikimi të aplikantit. 4. Certifikata e regjistrimit (kartoni i niptit)		
07.07.2016	Pershendetje te nderuar,	Ne lidhje me qendren tuaj per dorezimin e bilancit 2015, kam dy pyetje:  1.nje firme shpk, me ortak te huaj, qe nga muaji maj 2015, eshte me status pasiv ne tatime (per vitin 2015 nuk ka kryer asnje transaksion), nuk kryen aktivitet aktualisht, duhet te dorezoje bilanc per vitin 2015, prane qendres tuaj? duhet ta dorezoje dorazi apo online?  2.nje qender ojf e huaj, me	22.07.2016  Lidhur me pyetjet tuaja, ju sqarojmë si më poshtë vijon:  Së pari: Detyrimin për depozitimin pasqyrave finaciare e kanë subjektet që janë regjistruar me përgjegjësinë tatimore tatim fitimi, të cilët duhet të depozitojnë pranë QKB-së. Nëse subjekti për periudhën gjatë të cilës ka qenë me status aktiv ka qëne regjistruar si subjekt me përgjegjësi tatimore tatim fitimi, atëherë ky subjekt duhet të kryejë depozitimin e pasqyrave finaciare.		

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

		<p>drejtues të huaj, për vitin 2015 duhet të dorëzojë bilancin pranë qendres tuaj? online apo dorazi?</p> <p>faleminderit për bashkëpunimin.</p> <p>ne pritje të përgjigjeve tuaj.</p>	<p>Së dyti: Organizatat jofitimprurëse (ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja), nuk janë subjekte të regjistruara pranë Regjistrat Tregtar të administruar nga QKB. Për rrjedhojë, këto subjekte nuk depozitojnë pasqyra financiare pranë këtij Regjistri.</p>		
06.07.2016	<p>Pershendetje!</p> <p>Doja një informacion në lidhje me dorëzimin e Bilancit të 2015. Bizneset e vegjël me TVSH a duhet të dorëzojnë bilancin online pranë Jush ?</p> <p>Faleminderit paraprakisht!</p>	<p>22.07.2016</p> <p>Lidhur me pyetjen tuaj, ju sqarojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Detyrimin për depozitimin pasqyrave financiare e kanë subjektet që janë regjistruar <b>me përgjegjësinë tatimore tatim fitimi</b>, të cilët duhet të depozitojnë pranë QKB-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pasqyrat financiare vjetore të skanuara në format PDF.</li> <li>- Raporti i auditimit dhe ecurisë së veprimtarisë (kur mbajtja e tyre është e detyrueshme).</li> <li>- Vendimi për miratimin e pasqyrave financiare (sipas kërkesës ligjore).</li> </ul> <p>Depozitimi i dokumentave të sipërcituara mundësohet vetëm nëpërmjet aplikimit online në portalin qeveritar e-albania, duke ndjekur të gjitha hallkat e procedurës për kryerjen e aplikimit. Formatin elektronik i ruajtjes së pasqyrave financiare, duhet të jetë në PDF. Individit, i cili do të kryejë aplikimin, duhet të jetë i pajisur me kartë identiteti ose pasaportë biometrike. Shërbimi ofrohet pa pagesë.</p> <p><b>BËJNË PËRJASHTIM SUBJEKTET ME ADMINISTRATOR TË HUAJ DHE SHOQËRITË E KURSIMIT KREDITIT, APLIKIMET E TË CILEVE DO TË VIJOJNË TË KRYHEN VETËM NË SPORTELET E SHËRBIMIT TË QKB-së.</b></p>			

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKR-së [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

			Faleminderit!		
	04.07.2016	<p>Përshëndetje,</p> <p>Ju lutem a mund të më udhëzoni me hapat që duhet të ndjek për regjistrimin e një biznesi familjar, që konsiston në prodhimin e turshive në mënyrë artizanale? Po lexoj hapat në website tuaj, por nuk jam shumë e qartë.</p> <p>Faleminderit paraprakisht, Albana</p>	<p>22.07.2016</p> <p>Lidhur me pyetjen tuaj, ju sqarojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Çdo individ mund të regjistrohet pranë regjistrin tregtar si person fizik për ushtrimin e një aktiviteti ekonomik, për të cilin legjislacioni në fuqi nuk ka paracaktuar një formë të caktuar ligjore.</p> <p>Aplikimi për regjistrim fillestar, si dhe aplikimi për regjistrime të tjera të detyrueshme (si psh. ndryshime në të dhënat e regjistruara apo cregjistrimi) kushton vetëm 100 (njëqind) lekë.</p> <p>Për regjistrimin fillestar të personit fizik duhet të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dokument origjinal identifikimi (pasaportë biometrike, letërnjoftim elektronik);</li> <li>2. Formulari i aplikimit.</li> </ol> <p>Aplikim mund të bëhet në një sportel shërbimi të QKR-së, pavarësisht nga selia apo vendi i ushtrimit të veprimtarisë së subjektit që kërkon regjistrimin.</p> <p>Gjithashtu, aplikimi mund të kryhet edhe elektronikisht (on-line) në portalin qeveritar e-albania. Bashkëlidhur Manuali për regjistrimin fillestar të PERSONIT FIZIK.</p>		